

**HULUMTIM** **MBI**

# **VIKTMIZIMIN NGA KRIMI I URREJTJES**

**RAPORT**

**HULUMTIM MBI VIKTMIZIMIN  
NGA KRIMI I URREJTJES**

**RAPORT**

**Paul Iganski**

tetor 2023

Autore: Paul Iganski, PhD

Përktheu në shqip: Lindita Bilal Abdulahu

Redaktim gjuhësor: Fetije Topojani

Dizajni dhe printimi: Poliesterday, Shkup, 2023

Tirazh: 20

ISBN: 978-92-9271-200-6



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### QËLLIMET DHE SYNIMET

- ◆ Ky raport ofron konstatimet kryesore nga vala e dytë e hulumtimit të krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut të kryer në qershor dhe korrik 2023. Vala e parë është realizuar në vitin 2018.
- ◆ Duke përdorur të njëjtat pyetje në të dyja valët, hulumtimi synon të sigurojë një llogari më gjithëpërfshirëse të krimit të mundshëm nga urrejtja dhe viktimizimit nga incidentet sesa është në dispozicion nga numri i krimeve të urrejtjes të treguara nga të dhënat zyrtare dhe OJQ-të për shtetin.
- ◆ Synim kryesor ishte sigurimi i dëshmive për të ndihmuar në drejtimin e zhvillimit të masave efektive që i përgjigjen dhe luftojnë krimet nga urrejtja si dhe për të mbështetur përpjekjet e përfaqësimit të organizatave qytetare.

### DIZAJNI I HULUMTIMIT

- ◆ Vala e hulumtimit të vitit 2018 kishte për qëllim të maksimizonte potencialin për të kapur përvojën e pjesëmarrësve të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja. Qëllimi i valës së hulumtimit të vitit 2023 ishte arritja e një mostre përfaqësuese të të anketuarve bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2021.
- ◆ Mostra e vitit 2018 prej 1510 të anketuarve u zgjodh nga 18 komunat me laramani etnike me mendimin se shkallët e krimit të urrejtjes janë më të mëdha në zonat me llojlojshmëri më të madh të popullsisë. Vala e hulumtimit të vitit 2023 përfshiu gjithsej 67 komuna dhe rekrutoi një mostër prej 1614 të anketuarve.
- ◆ Të dyja valët e hulumtimit përdorën dizajn të mostrës bazuar në kuota.
- ◆ Intervistat u zhvilluan me ndihmën e tabletit (Tablet assisted self-interviews - TASI) në të cilat të anketuarit plotësuan një pyetësor anketimi duke përdorur një kompjuter-tablet të siguruar nga intervistuesi.
- ◆ Të anketuarit u rekrutuan në vende publike në lokacione dhe kohë të zgjedhura për të marrë mostrën e një prerjeje të tërthortë të popullsisë.

### VIKTIMIZIMI I MUNDSHËM NDAJ KRIMIT

- ◆ Konstatimet e hulumtimit në lidhje me viktimizimin e mundshëm ndaj krimit në përgjithësi zbulojnë një ngjashmëri të habitshme në shkallët e viktimizimit për 2018 dhe 2023.
- ◆ Ka disa indikacione të lëvizjes në drejtim të një rënieje të vogël në shkallët e përgjithshme të viktimizimit ndaj krimeve në përgjithësi.
- ◆ Shkallët e viktimizimit për shumicën e krimeve specifike të pyetura në hulumtim duket se kanë rënie të vogël nga viti 2018, por shumica e dallimeve nuk dëshmojnë një ndryshim kur gjykohen nga standardet e probabilitetit statistikor.

## VIKTIMIZIMI I MUNDSHËM PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA

- ◆ Konstatimet e hulumtimit në lidhje me viktimizimin e mundshëm për shkak të krimit nga urrejtja tregojnë shpërndarje shumë më të lartë sesa sugjerohet nga të dhënat zyrtare dhe OJQ-të, për të dyja valët e hulumtimit.
- ◆ Nuk ka pasur asnjë ndryshim në shkallën e përgjithshme të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit nga urrejtja ndërmjet viteve 2018 dhe 2023.
- ◆ Shkalla e mundshme e viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja për pjesëmarrësit e vitit 2023 si grup nga komunitatet e përfshira në hulumtim nga viti 2018 është më e lartë se shkalla e përgjithshme e të anketuarve të hulumtimit nga viti 2023 nga komunitatet e tjera dhe nuk ka asnjë ndryshim të dukshëm në shkallën e viktimizimit që nga viti 2018. Kjo mbështet arsyetimin për përzgjedhjen e komunave në vitin 2018 që zonat me llojllojshmëri më të madhe etnike do të përjetojnë shkallë më të mëdha të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja.
- ◆ Modeli i motivimeve nga paragjykimet e ndryshme të perceptuara për krimet dhe incidentet nga urrejtja është gjithashtu i ngjashëm ndërmjet valëve të hulumtimit në 2018 dhe 2023. Megjithatë, ka një ndryshim të dukshëm nga anketa e vitit 2018. Përqindja e krimeve të mundshme të urrejtjes dhe incidenteve me një paragjykim të perceptuar politik është ulur.
- ◆ Të huajt ishin lloji më i zakonshëm i kryerësit të krimit nga urrejtja.
- ◆ Shumë pak viktimat të krimit nga urrejtja thanë se autori i krimit ishte anëtar i një grupi ekstremist.

## VIKTIMIZIMI SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË VIKTIMËS

- ◆ Hulumtimi i vitit 2023 nuk tregon asnjë ndryshim në shkallën e përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit midis femrave dhe meshkujve. Megjithatë, tregon një ulje të mundshme të shkallës së përgjithshme të viktimizimit nga krimi për meshkujt krahasuar me hulumtimin e vitit 2018.
- ◆ Femrat dhe meshkujt nuk përjetuan asnjë ndryshim në shkallën e përgjithshme të krimit të mundshëm nga urrejtja dhe viktimizimit ndaj incidenteve në valën e vitit 2023 të hulumtimit. Situata ishte e njëjtë edhe në vitin 2018. Gjithashtu nuk ka ndryshim të dukshëm në shkallët e mundshme të krimit të urrejtjes dhe viktimizimit ndaj incidenteve për femrat dhe meshkujt midis dy anketave.
- ◆ Një përqindje më e lartë e të anketuarve me aftësi të kufizuara nga komunitatet e përfshira të vitit 2018 në valën e vitit 2023 të hulumtimit kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm në 12 muajt e mëparshëm krahasuar me të anketuarit me aftësi të kufizuara në valën e vitit 2018 të hulumtimit.
- ◆ E njëjta gjë vlen edhe për viktimizimin e mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja, duke treguar rritje ndërmjet dy valëve të hulumtimit.
- ◆ Shkalla e mundshme e viktimizimit nga krimi i urrejtjes ka mbetur statike ndërmjet dy valëve të hulumtimit për të anketuarit shqiptarë si grup dhe gjithashtu për të anketuarit maqedonas.
- ◆ Megjithatë, për viktimizimin e mundshëm nga krimi në përgjithësi, ka pasur një rënie të shkallës së viktimizimit për të anketuarit shqiptarë si grup që nga viti 2018, ndërsa shkalla ka mbetur statike për të anketuarit maqedonas.

## RAPORTIMI NË POLICI

- ◆ Krimet dhe incidentet e mundshme me një motivim të perceptuar të njëanshmërisë ka më shumë të ngjarë të raportohen në polici për disa lloje të krimeve - sulme verbale dhe viktimizim i tërthortë- krahasuar me ata pa motivim të njëanshmërisë.

## POST-VIKTIMIZIMI DHE SHQETËSIMI PËR VIKTIMIZIMIN E MUNDSHËM PËR SHKAK TË KRIMIT

- ◆ Viktimat e krimit nga urrejtja si grup kishin mbi dy herë më shumë gjasa, se viktimat e krimeve të tjera, të raportonin probleme të rëndësishme me anëtarët e familjes ose miqtë si pasojë e përvojës së tyre të krimit nga urrejtja.
- ◆ Viktimat e krimit nga urrejtja si grup kishin më shumë gjasa të raportonin ndikimin psikologjik pas viktimizimit sesa viktimat e krimeve të tjera.
- ◆ Ekziston një tendencë në rënie në lidhje me viktimizimin e mundshëm nga krimi ndërmjet viteve 2018 dhe 2023. Ky është rasti për secilin tregues shqetësimi për të anketuarit që nuk kishin qenë viktima të krimit dhe ata që kishin qenë viktima të krimeve të incidenteve që nuk janë perceptuar si të motivuara nga njëanshmëria në 12 muajt e mëparshëm.
- ◆ Ekziston gjithashtu një tendencë në rënie në lidhje me brengosjen për viktimizimin e mundshëm nga krimi ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 për viktimat e krimeve nga urrejtja dhe incidenteve në shumicën e treguesve.

## CONTENTS

Përmbledhje ekzekutive . . . . .	3
<b>1. HYRJE . . . . .</b>	<b>8</b>
<b>2. DIZAJNI I HULUMTIMIT . . . . .</b>	<b>9</b>
Dizajni i mostrave . . . . .	9
Përzgjedhja e mostrave . . . . .	9
Puna në terren . . . . .	10
Pyetësi i intervistës . . . . .	11
Përkufizimi i “krimit nga urrejtja” në hulumtim . . . . .	11
Prezantimi i rezultateve të hulumtimit në këtë raport . . . . .	12
<b>3. VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT . . . . .</b>	<b>14</b>
Shkallët e përgjithshme të viktimizimit . . . . .	14
Llojet e krimeve të përjetuara . . . . .	15
Konkluzione: Krahasimi i shkallëve të përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit për vitin 2018 dhe 2023 . . . . .	20
<b>4. VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA . . . . .</b>	<b>21</b>
Shkallët e përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja . . . . .	21
Viktimizimi për shkak të krimit nga urrejtja dhe incidentet sipas llojit të krimit . . . . .	21
Numri i krimeve dhe incidenteve nga urrejtja . . . . .	22
Motivimi nga njëanshmëria . . . . .	24
Treguesit e njëanshmërisë . . . . .	26
Kryerësit . . . . .	27
Konkluzione: krahasimi i shkallëve të viktimizimit nga krimi për vitin 2018 dhe 2023 . . . . .	28
<b>5. VIKTIMIZIMI SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË VIKTIMËS . . . . .</b>	<b>29</b>
Shkalla e përgjithshme e viktimizimit sipas gjinisë . . . . .	29
Gjinia dhe viktimizimi për shkak të krimit nga urrejtja . . . . .	29
Mosha dhe viktimizimi për shkak të krimit . . . . .	30
Viktimizimi nga krimi ndaj moshës dhe krimi nga urrejtja . . . . .	30
Aftësia e kufizuar dhe shkalla e viktimizimit . . . . .	31
Aftësia e kufizuar dhe viktimizimi për shkak të krimit nga urrejtja . . . . .	32
Përkatësia etnike dhe viktimizimi . . . . .	32
Religjioni dhe viktimizimi . . . . .	33
Orientimi seksual dhe viktimizimi . . . . .	33
<b>6. RAPORTIMI NË POLICI . . . . .</b>	<b>35</b>
Shkalla e raportimit . . . . .	35
Shkalla e raportimit sipas llojit të krimit . . . . .	35
Arsyet e mos denoncimit të krimeve dhe incidenteve në polici . . . . .	36

<b>7. NDIKIMI PAS VIKTIMIZIMIT DHE SHQETËSIMI PËR SHKAK TË KRIMIT</b> . . . . .	38
Të ndikuar nga viktimizimi ndaj krimit . . . . .	38
Ndikimi socio-emocional . . . . .	39
Ndikimi psikologjik . . . . .	39
Shqetësimi për shkak të viktimizimit të mundshëm nga krimi . . . . .	40
<b>8. KONKLUZION</b> . . . . .	43

### List of figures and tables

#### **FIGURES**

Figura 1: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën fyerje, sulm verbal ose kërcënim për sigurinë në 12 muajt e fundit .....	15
Figura 2: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën një krim pronësie në 12 muajt e fundit ..	16
Figura 3: Përqindjet e të anketuarve refuzuan ndihmën mjekësore kur ishte e nevojshme të paktën një herë në 12 muajt e fundit.....	17
Figura 4: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën një sulm fizik ose seksual në 12 muajt e fundit.....	18
Figura 5: Përqindjet e të anketuarve të privuar në mënyrë të paligjshme nga liria të paktën një herë në 12 muajt e fundit.....	18
Figura 6: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar viktimizim mëkëmbës të pakeën një herë në 12 muajt e fundit.....	19
Figura 7: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën një krim ose incident të mundshëm të urrejtjes në 12 muajt e fundit.....	22
Figura 8: Numri i krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja sipas llojio të krimit: anketa e vitit 2023 .....	23
Figura 9: Përqindjet e viktimave që vënë në dukje motivimin nga paragjykimi sipas kategorisë së krimit ....	24
Figura 10: Motivet e paragjykimit nga viktimat e krimit nga urrejtja .....	25
Figura 11: Treguesit e njëanshmërisë për krimet e mundshme nga urrejtja etnike, racore ose kombëtare, 2023 .....	27
Figura 12: Viktimizimi i krimit sipas grup moshës .....	30
Figura 13: Viktimizimi i krimit nga urrejtja sipas grupmoshës.....	31
Figura 14: Ndikimi psikologjik i viktimizimit të krimit nga urrejtja .....	40
Figura 15: Shqetësimi për krimin.....	42

#### **TABLES**

Tabela 1: Kryerësit e krimeve dhe incidenteve nga urrejtja dhe krimeve dhe incidenteve të tjera .....	28
Tabela 2: Etnia dhe viktimizimi i mundshëm .....	33
Tabela 3: Të anketuarit sipas orientimit seksual 2018 dhe 2023 .....	34
Tabela 4: Viktimat që nuk kanë raportuar krimet ose incidentet që kanë përjetuar në polici sipas motivimit nga njëanshmëria dhe kategorisë së krimit .....	36
Tabela 5: Arsyet pse shumica e krimeve të rënda nuk janë raportuar në polici .....	37
Tabela 6: Të prekurit nga viktimizimi për shkak të krimit.....	38
Tabela 7: Problemet socio-emocionale pas viktimizimit nga krimi .....	39
Tabela 8: Shqetësimi për viktimizimin e mundshëm për shkak të krimit.....	41



# 1. HYRJE

Ky raport ofron konstatimet kryesore nga vala e dytë e hulmtimit të krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut të kryer në qershor dhe korrik të vitit 2023. Vala e parë e hulmtimit në vitin 2018 ishte unike. Ishte anketa e parë që synonte të kapte përvojën e viktimizimit të mundshëm nga krimi nga urrejtja në vend. Ishte gjithashtu anketa e parë e krimit nga urrejtja për vendet jashtë BE-së në rajonin e Ballkanit. Vala e dytë vazhdon kontributin e veçantë të hulmtimit për të kuptuar krimin nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut. Ajo ofron një përshkrim të përditësuar të shpërndarjes së krimit të mundshëm nga urrejtja. Ndërsa mundëson një vlerësim të ndryshimit të mundshëm që nga viti 2018.

Anketa ofron një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të viktimizimit të mundshëm ndaj krimit nga urrejtja në vend sesa ajo që është e mundur nga të dhënat zyrtare dhe të OJQ-ve në dispozicion, duke vlerësuar përvojat e një sërë bashkësish të ndryshme të identitetit shoqëror të shumicës dhe pakicës bazuar në përkatësinë etnike, fenë, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar dhe bindjet politike.

Një synim kryesor është sigurimi i provave për të ndihmuar në drejtimin e zhvillimit të masave efektive që i përgjigjen dhe luftojnë krimet nga urrejtja si dhe për të mbështetur përpjekjet e përfaqësimit nga organizatat e shoqërisë civile.<sup>1</sup> Krahasimi i konstatimeve nga valët 2018 dhe 2023 të hulmtimit gjithashtu informon vlerësimin e masave të marra gjatë pesë viteve të fundit për të adresuar problemin e krimit nga urrejtja.

Raporti është i organizuar në tetë pjesë. Pas kësaj pjese hyrëse, janë përshkruar disa çështje kryesore metodologjike në lidhje me hartimin e hulmtimit dhe analizën e të dhënave për të informuar interpretimin e rezultateve të hulmtimit. Më pas vijojnë pjesët e veçanta për: shpërndarjen e viktimizimit nga krimi; shpërndarjen e viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja; viktimizimin ndaj krimit nga urrejtja sipas karakteristikave të viktimës; raportimin në polici; dhe shqetësimin për krimin. Konstatimet e anketave nga viti 2018 dhe 2023 krahasohen nëpër të gjithë raportin, me komentet e dhëna në lidhje me çdo ndryshim të vërejtur. Pjesa e fundit paraqet konkluzionet raportit.

---

1 OSBE ODIHR-i propozon që: "Mjetet që matin krimet e paraportuara nga urrejtja dhe ndikimin e tyre te viktimat mund të ofrojnë një tregues më të mirë të vëllimit të vërtetë të krimeve nga urrejtja si dhe informata të vlefshme në lidhje me ndikimin e krimeve nga urrejtja te viktimat. Ata mund të identifikojnë bashkësitë specifike në rrezik dhe të japin informata në lidhje me modelet ndryshuese të dhunës. Ata mund të ndihmojnë në vlerësimin e nivelit të besimit të bashkësisë në policinë dhe agjencitë e tjera të të drejtës penale. Të gjitha këto njohuri mund të ndihmojnë në përmirësimin e planifikimit, veprimit parandalues dhe reagimit." *Hate Crime Data-Collection and Monitoring Mechanisms. A Practical Guide*, (2014: Warsaw: OSCE/ODIHR, page 33).

# 2. DIZAJNI I HULUMTIMIT

## DIZAJNI I MOSTRAVE

Vala e hulumtimit të vitit 2018 kishte për qëllim të maksimizonte potencialin për të kapur përvojën e pjesëmarrësve të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja. Mostra u zgjodh nga 18 komunat me laramani më të madhe etnike me mendimin se shkallët e krimit të urrejtjes janë më të mëdha në zonat me llojllojshmëri më të madh të popullsisë.<sup>2</sup> Një qëllim i valës së hulumtimit të vitit 2023 ishte arritja e një mostre përfaqësuese të të anketuarve bazuar në regjistrimin e fundit të popullsisë 2021.<sup>3</sup> Prandaj, vala e vitit 2023 përfshiu 18 komunat nga anketa e vitit 2018, por zgjeroi shtrirjen e saj për të mbuluar gjithsej 67 komuna.

Të dyja valët e hulumtimit përdorën dizajn të mostrës bazuar në kuota. Kufizimet buxhetore kufizojnë potencialin për hulumtim nacional me mostër të rastësishme – madje edhe para se të shqyrtohet disponueshmëria e kornizave të përshtatshme të marrjes së mostrave për një hulumtim të tillë. Shpenzimet rriten kur kërkohen të vëzhgohen një sërë bashkësish të ndryshme të identitetit shoqëror të shumicës dhe pakicës - i cili është një tjetër synim i hulumtimit të krimit nga urrejtja.

Mostrat me kuota ofrojnë dizajn ekonomik për përzgjedhjen e mostrave. Mund të jetë gjithashtu dizajn shumë i besueshëm kur bëhet përsëritja e hulumtimeve me kalimin e kohës, siç tregohet me krahasimet në këtë raport të konstatimeve nga të dy valët e hulumtimit të krimit nga urrejtja.

## PËRZGJEDHJA E MOSTRAVE

Madhësia e mostrës së të anketuarve në secilën komunë dhe rajonet në të cilat ndodhen komunat, ishte proporcionale me popullsinë e komunës dhe rajonit si përqindje e popullsisë së përgjithshme për vendin. Për mostrat me kuota:

- ◆ Mostra për secilën komunë u nda në mënyrë proporcionale sipas përbërjes së grupit etnik të komunës (maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vllleh, serbë, boshnjakë dhe të tjerë).
- ◆ Në secilën komunë, 60% e mostrës në valën e vitit 2023 të hulumtimit ishin meshkuj dhe 40% femra (në vitin 2018, 75% ishin meshkuj dhe 25% femra. Qëllimi i mbipërfaqësimit të meshkujve ishte të përpiquej të kapte një pamje sa më gjithëpërfshirëse të viktimizimit nga krimi duke qenë se meshkujt kanë pak më shumë gjasa se femrat të jenë viktime të krimit të dhunshëm në vende publike dhe kundërvajtjeve të rendit publik - llojet e krimeve që zakonisht përkeqësohen në krime të urrejtjes).
- ◆ Grupmoshat më të reja ishin gjithashtu të mbipërfaqësuar në krahasim me grupmoshat më të vjetra në të dy valët e hulumtimit, gjithashtu duke synuar të kapnin një pamje sa më gjithëpërfshirëse të viktimizimit të mundshëm nga krimi. Meshkujt e rinj të moshës madhore kanë më shumë gjasa të jenë viktime të dhunës me një shkallë të viktimizimit në

2 Iganski, P. (2007) *Hate Crime and the City*, Bristol, UK: Policy Press. (Shih kapitullin 3: 'The spatial dynamics of everyday hate crime', Bristol: Policy Press, faqet 45-71.

3 Enti Shtetëror i Statistikave i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2022) *Popullsia, Amvisëritë dhe Banimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Regjistrimi 2021*, Shkup: Enti Shtetëror i Statistikave i Republikës së Maqedonisë së Veriut, [https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/POPIS\\_DZS\\_web\\_EN.pdf](https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/POPIS_DZS_web_EN.pdf)

rënie me moshën. Në hulumtimin e vitit 2023, u zgjodh dyfishi i përqindjes së popullsisë kombëtare të moshës 15-19 vjeç, 20-24 vjeç dhe 25-29 vjeç; një përqindje e barabartë e popullsisë kombëtare prej 30-39 vjeç; dhe gjysma e përqindjes së popullsisë kombëtare të zgjedhur për grupmoshat më të vjetra. Të njëjtat përmasa sipas moshës janë përzgjedhur në valën e vitit 2018 të hulumtimit.

## PUNA NË TERREN

Puna në terren për të dyja valët e hulumtimit u krye nga kompania BRIMA nga Maqedonia e Veriut, me rreth 51 intervistues maqedonas dhe shqiptarë me përvojë të mëparshme për valën e vitit 2023.<sup>4</sup>

Anketuesit iu drejtuan 1,792 personave për valën e hulumtimit të vitit 2023: 178 refuzuan të anketohen (10%) ndërsa 1,614 të anketuar të moshës 15 vjeç e lart morën pjesë në hulumtim. Shkalla e refuzimit për vitin 2018 ishte pak më e lartë me 12.9%.

Deklarata e mëposhtme e rekrutimit u përdor në të dyja valët e hulumtimit:

- ◆ Mirëmëngjesi/mirëdita/mirëmbrëma, quhem \_\_\_\_\_ dhe punoj për BRIMËN. Ne po kryejmë një hulumtim që synon të kuptojë shpërndarjen e krimeve për të cilat viktimat besojnë se janë të motivuara nga urrejtja ose njëanshmëria i kryerësit ndaj tyre. Do të pyeteni për arsyet siç janë: përkatësia etnike, racore ose kombëtare, në veçanti për shkak të përkatësisë fetare, në veçanti për shkak të aftësisë së kufizuar fizike ose mendore, në veçanti për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe në veçanti për shkak të bindjeve politike. Ne zgjedhim personin në mënyrë të rastësishme. Përgjigjet e hulumtimit janë rreptësishtë konfidenciale, në përputhje me standardet ndërkombëtare kërkimore. Të dhënat tuaja personale të shënuara në këtë Pyetësor do të përpunohen nga SHPK BRIMA Shkup, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe për qëllimet e këtij hulumtimi.

Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të disa prej pyetjeve të hulumtimit, u kryen intervista individuale të ndihmuara nga tabletët (TASI) në të cilët pjesëmarrësit plotësuan një pyetësor paraprakisht të koduar të hulumtimit duke përdorur një tablet të siguruar nga intervistuesi. Kalimi nëpër pyetësor ka ndjekur përgjigjet e të anketuarit. Pyetësori ishte në dispozicion si në gjuhën maqedonase ashtu edhe në gjuhën shqipe. Intervistuesit ishin të pranishëm për të adresuar çdo pyetje nga të anketuarit lidhur me çdo sqarim të nevojshëm lidhur me formulimin e pyetjeve.

Intervistat u zhvilluan gjatë gjithë ditës duke përfshirë mbrëmjet e hershme dhe fundjavat për të kapur të anketuarit e mundshëm që ishin në punë gjatë ditës ose në shkollë ose fakultet.

Të anketuarit u rekrutuan në vende publike në vendet e zgjedhura për të arritur një prerje tërthore të popullsisë - pranë ose afër stacioneve hekurudhore, stacioneve të autobusëve, zyrave postare, qendrave mjekësore dhe spitaleve, qendrave tregtare dhe kinemave. Intervistuesit u udhëzuan gjithashtu të shkonin në vende ose lagje të veçanta ku mund të gjenin grupet e tyre të synuara, siç janë për shembull pakicat ose njerëzit nga grupe të caktuara etnike dhe grupmosha të veçanta, për të plotësuar kuotat e tyre.

4 Shif: <https://www.kantartns-see.com/locations-in-south-east-europe/north-macedonia/>

## PYETËSORI I INTERVISTËS

Para kryerjes së punës në terren për hulumtimin e vitit 2018, u ndërmor një pilot për rekrutim të të anketuarve dhe plotësim të pyetësorit nën të njëjtat kushte siç ishte planifikuar për hulumtimin. I njëjti pyetësor u përdor si në valën e hulumtimit të vitit 2018 ashtu edhe në atë të vitit 2023. Pyetjet u organizuan në pesë module. Sipas:

- ◆ Të dhënave demografike.
- ◆ Shqetësimeve për krimin.
- ◆ Përvoja e viktimizimit të mundshëm nga krimi, duke u përqendruar në 11 lloje të ndryshme specifike të krimit.
- ◆ Krimi më i rëndë i mundshëm i përjetuar.
- ◆ Ndikimi i krimit më të rëndë të mundshëm të përjetuar.

U përdor një periudhë referimi prej 12 muajve të fundit para intervistës, për të gjitha pyetjet në lidhje me përvojën e krimit.

## PËRKUFIZIMI I “KRIMIT NGA URREJTJA” NË HULUMTIM

“Krimi nga urrejtja” përkufizohet nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) si “veprime kriminale të motivuara nga njëanshmëria ndaj grupeve të veçanta të njerëzve”.<sup>5</sup> Këta dy komponentë të krimit nga urrejtja- vepër penale dhe motivim nga njëanshmëria - përcaktohen gjithashtu nga Kodi penal i Maqedonisë së Veriut (i ndryshuar 2018). Aty thuhet se një: “Krim nga urrejtja... kryhet tërësisht ose pjesërisht për shkak të një karakteristike ose lidhja reale ose spekulative (imagjinare, supozuese) e të personit dhe lidhet me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, origjinën etnike, fenë ose bindjen, aftësinë e kufizuar mendore ose trupore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjen politike.” (Neni 122 [42]). Këto ‘karakteristika’, ose ‘lidhje’, të personave u përdorën për matjen e krimit të mundshëm nga urrejtja në valët 2018 dhe 2023 të hulumtimit të krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut.

Për secilin nga njëmbëdhjetë llojet specifike të krimit të pyetur në hulumtim, të<sup>6</sup> anketuarit që treguan se kishin qenë viktimë e krimit në 12 muajt e fundit u pyetën në pyetjet vijuese nëse mendonin se kjo ka ndodhur pjesërisht ose plotësisht për shkak të:

- ◆ Përkatësisë së tyre etnike, racore ose kombëtare.
- ◆ Përkatësisë së tyre fetare.
- ◆ Bindjeve politike.
- ◆ Orientimit seksual ose identitetit gjinor (nëse ata kishin treguar se orientimi i tyre seksual ishte ndryshe nga ai “heteroseksual”).
- ◆ Gjendja e shëndetit fizik ose mendor ose sëmundja (nëse tregonin se kishin një gjendje të shëndetit fizik ose mendor ose sëmundje që zgjaste ose pritej të zgjaste për 12 muaj ose më shumë).

5 <https://hatecrime.osce.org/>

6 Analiza e anketës së vitit 2018 përdori tetë nga njëmbëdhjetë llojet specifike të krimit. Analiza e të dhënave të vitit 2023 përdori të 11 llojet specifike të krimit të pyetura në anketë me qëllim të kapjes së të gjitha krimeve dhe incidenteve nga urrejtja të shënuara nga të anketuarit pa përjashtim. Të gjitha krahasimet e viktimizimit të mundshëm nga krimet dhe incidentet midis valëve të anketës së vitit 2018 dhe 2023 përdorin të njëmbëdhjetë llojet specifike të krimit.

Për më tepër, për të anketuarit kur janë pyetur për krimin më të rëndë të specifikuar, ata janë pyetur më tej: 'A mendoni se...(kjo)...ka ndodhur pjesërisht ose plotësisht sepse jeni grua?'

Kundërvajtjet që lidhen me përgjigjet pozitive ndaj secilës prej këtyre pyetjeve klasifikohen në këtë raport si "krime dhe incidente të mundshme nga urrejtja", ndërsa veprat tjera që nuk perceptohen si të motivuara nga njëanshmëria referohen si "krime dhe incidente të mundshme".<sup>7</sup> Përdorimi i fjalës "mundshme" njihet se në praktikë, verifikimi sigurohet përfundimisht nga gjykatat. Për më tepër, shtimi i fjalës "incidente" njihet se jo të gjitha rastet e viktimizimit të shënuara nga të anketuarit e hulumtimit përbëjnë krime siç përcaktohet nga Kodi penal i Maqedonisë së Veriut. Nga të dhënat e hulumtimit, nuk është e mundur të verifikohet ligjërisht nëse incidentet e shënuara nga të anketuarit kualifikohen si krime sipas ligjit. Por kjo është e përbashkët me anketat ndërkombëtare të viktimizimit nga krimi.

## PREZANTIMI I REZULTATEVE TË HULUMTIMIT NË KËTË RAPORT

Për llogaritjen e rezultateve të hulumtimit, u zbatua ponderimi për të korigjuar statistikat e mostrës 2023 sipas parametrave të popullsisë për grupin etnik, gjininë, moshën, rajonet dhe vendndodhjen urbane/rurale, sipas regjistrimit të vitit 2021, duke përdorur ponderimin RIM. Mostra e vitit 2018 u ponderua sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2002. Të gjitha rezultatet e paraqitura janë rezultate të ponderuara - përveç kur paraqiten numërimet e krimeve aktuale të përjetuara. Siç është konvencionale kur raportohen konstatimet e hulumtimit të mostrave me kuotë, për rezultatet e raportuara paraqiten përqindjet e ponderuara dhe numri i paponderuar i të anketuarve (n) nga të cilat rrjedhin përqindjet.<sup>8</sup>

Ekziston një konsensus midis studiuesve socialë se përzgjedhja jo e rastësishme e të anketuarve përmes marrjes së mostrave të kuotave parandalon përgjithësimin e konstatimeve të hulumtimit përtej pjesëmarrësve të hulumtimit. Kjo për shkak se vlerësimet e popullsisë, ose përgjithësimi i konstatimeve, mbështeten nga premisa e marrjes së mostrave rastësore, pasi një qasje e tillë shmang paragjykimet nga përzgjedhja e mostrës. Marrja e mostrave të kuotave mendohet të jetë e njëanshme ndaj njerëzve që janë të gatshëm, të lehtë për t'u arritur dhe të interesuar për temën.<sup>9</sup> Kjo është problematike nëse ata dallohen si grup nga pjesa tjetër e popullsisë në lidhje me temat e hulumtimit.

Edhe pse ponderimi i valëve të hulumtimit për krimin nga urrejtja të vitit 2018 dhe 2023 të i përshtati mostrat që të ngjanin më shumë me popullatat nga të cilat u morën mostrat e të anketuarve, premisa e marrjes së mostrave rastësore është ende ajo se rezultatet nga mostrat e kuotave pa probabilitet nuk mund të përgjithësohen.

Megjithatë, konstatimet e ponderuara të hulumtimit të paraqitura në këtë raport janë dëshmi për forcën e modelit të marrjes së mostrave të kuotave të përdorura për hulumtimin. Në shumë pyetje të bëra për të anketuarit, rezultatet e valëve të hulumtimit për v. 2018 dhe 2023 janë jashtëzakonisht të ngjashme. Prandaj, rezultatet e hulumtimit mund të interpretohen si potencialisht

7 Sipas Kodit penal të Maqedonisë së Veriut 2018, rritja e dënimit në rastet që përfshijnë motivimin nga urrejtja u përfshi gjithashtu për: Vrasje (neni 123); Detyrim (neni 139); Torturë dhe trajtim dhe dënim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues (neni 142); Sulm seksual ndaj një personi të pafuqishëm (neni 187); Sulmi seksual ndaj një fëmije që nuk ka mbushur 14 vjeç (neni 188); Grabitje me armë (neni 238); Zhvatje (neni 258); Shkaktimi i urrejtjes, përçarjes ose jotolerancës në baza kombëtare, racore, fetare ose ndonjë diskriminimi tjetër (neni 319); Pjesëmarrja në një turmë që kryen krime (vepra dhune) (neni 385); Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit të informacionit (neni 394-d); Miratimi ose justifikimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës (neni 407-a); Diskriminimi racor ose tjetër (neni 417);

8 Për logjikën e kësaj qasjeje shih: Tim Bock 'The Correct Treatment of Sampling Weights in Statistical Tests' *DISPLAYR*, <https://www.displayr.com/the-correct-treatment-of-sampling-weights-in-statistical-tests/> Qasja e fundit: 16.08.23.

9 Për një rishikim të dobishëm të literaturës akademike mbi këtë temë, shih: literaturën: Keming Yang dhe Ahmad Banamah (2014) 'Quota Sampling as an Alternative to Probability Sampling? An Experimental Study', *Sociological Research Online*, 19(1), fq. 56-66: <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.5153/sro.3199>

treguese për popullsinë më të gjerë përtej pjesëmarrësve të hulumtimit, gjë që do të jetë interesi i shumë lexuesve të këtij raporti.

Për të ndihmuar në interpretimin e konstatimeve të hulumtimit ndiqen konventa të caktuara bazuar në raportimin e rezultateve nga anketat e probabilitetit. Meqenëse rezultatet e bazuara në një numër të vogël përgjigjesh në një hulumtim janë më pak të besueshme se të tjerat, praktika e përdorur nga Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) në raportet mbi hulumtimin EUMIDISII<sup>10</sup> është përshtatur për këtë raport:

- ◆ Rezultatet e bazuara në 20 deri në 49 numra të paponderuar të të anketuarve, në një total të grupit ose në bazë të fushave me më pak se 20 të anketuar të paponderuar, shënohen në kllapa.
- ◆ Rezultatet e bazuara në më pak se 20 të anketuar të paponderuar në totalin e një grupi nuk janë paraqitur (me vetëm disa përjashtime - për qëllime treguese - të cilat shënohen aty ku është e zbatueshme).

Për shkak se hulumtimet me mostër intervistojnë vetëm një pjesë të popullsisë, ato janë lëndë e gabimit gjatë marrjes së mostrave. Testet me rëndësi statistikore zbatohen në mënyrë konvencionale për rezultatet e hulumtimit për të përcaktuar nëse dallimet e vërejtura midis grupeve të popullsisë duhet të konsiderohen si dallime aktuale në popullsinë e përgjithshme - me probabilitet prej 95% brenda intervalit të variacionit statistikor.

Duke pasur parasysh se rezultatet e hulumtimit për krimin nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut rrjedhin nga mostrat e kuotave me zgjedhje të rastësishme, megjithatë, testet me rëndësi statistikore nuk ofrohen në mënyrë rutinë për rezultatet e dhëna në këtë raport - pasi një supozim kryesor pas testimit të rëndësisë është se rezultatet bazohen në një mostër të rastësishme të të anketuarve. Megjithatë, për të ndihmuar në interpretimin e disa dallimeve kryesore të vëzhguara midis nëngrupeve të të anketuarve, ose ndërmjet valëve të hulumtimit të v. 2018 dhe 2023, jepen komente nëse këto dallime do të konfirmoheshin nga teste me rëndësi statistikore nëse mostrat do të ishin nxjerrë nga mostra të rastësishme.

<sup>10</sup> Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Anketa e dytë e Bashkimit Evropian mbi Pakicat dhe Diskriminimin. Rezultatet kryesore (Luksenburg: Zyra e botimeve e Bashkimit Evropian, 2017, Faqe 116): [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2017-eu-midis-ii-main-results\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2017-eu-midis-ii-main-results_en.pdf)

# 3. VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT

## SHKALLËT E PËRGJITHSHME TË VIKTIMIZIMIT

Për të kuptuar shpërndarjen e krimit nga urrejtja, pjesëmarrësit u pyetën në përgjithësi për viktimizimin e mundshëm nga krimi, ndërsa më pas për çdo motivim të perceptuar nga njëanshmëria për krimet dhe incidentet e mundshme të përjetuara. Shqyrtimi i kësaj përvoje të përgjithshme të krimit së pari, në këtë pjesë, ofron një kontekst të dobishëm për shqyrtimin e konstatimeve në lidhje me krimin nga urrejtja në pjesën tjetër të raportit.

Si pikënisje për të pyetur për përvojat e viktimizimit nga krimi në përgjithësi, të gjithë të anketuarit u pyetën: ‘A keni qenë viktimë e një krimi gjatë vitit të kaluar në këtë shtet?’. Pothuajse një e katërta (24%) e pjesëmarrësve në vitin 2023 u përgjigjën se kishin qenë viktimë e krimit, krahasuar me një të tretën (33%) në valën e hulumtimit të vitit 2018. Një pjesë e këtij dallimi hiqet kur bëhet përqendrimi vetëm në të anketuarit nga tetëmbëdhjetë komunat e përfshira nga vala e hulumtimit të vitit 2018. Megjithatë, ende mbetet një dallim pasi 28.4% e pjesëmarrësve të vitit 2023 nga komunat nga viti 2018 deklaruan se kishin qenë viktimë e krimit gjatë vitit të kaluar. Në këtë masë të gjerë, ka indikacione për një rënie të mundshme të shkallës së përgjithshme të viktimizimit të mundshëm të krimit që nga viti 2018. Kjo duket se i përshtatet prirjes së vogël rënese të krimit në vitet e fundit, siç tregohet nga statistikat zyrtare mbi numrin e kryerësve të krimeve të moshës madhore – megjithëse numri më i fundit për vitin 2022 është vetëm pak më i ulët se ai 2018.<sup>11</sup>

Për të mundësuar një kuptim më të afërt të përvojës së viktimizimit të të anketuarve, pyetjet e mëtejshme të hulumtimit në lidhje me viktimizimin nga krimi u kufizuan në njëmbëdhjetë lloje të ndryshme të kundërvajtjeve.<sup>12</sup> Njëmbëdhjetë kategoritë e kundërvajtjeve u zgjedhën fillimisht për hulumtimin e vitit 2018 pasi që një grup pune i Ministrisë së Drejtësisë kishte propozuar në atë kohë ndryshime në Kodin Penal për të përfshirë rritjen e dënimit për secilën nga kundërvajtjet në rastet kur ishte i përfshirë motivimi nga urrejtja.<sup>13</sup> Për të mundësuar krahasimin ndërmjet valëve të hulumtimit të vitit 2018 dhe 2023, u mbajtën pyetjet specifike për të njëjtat njëmbëdhjetë kategori të kundërvajtjeve edhe për valën 2023 dhe u përdorën për krahasimin e shkallëve të mundshme të viktimizimit.

Për të njëmbëdhjetë kategoritë e kundërvajtjeve të kombinuara, 22.5% e pjesëmarrësve të vitit 2023 raportuan se kishin përjetuar të paktën një krim ose incident të mundshëm në 12 muajt para hulumtimit - përsëri më e ulët se vala e hulumtimit të vitit 2018 ku 32.2% e pjesëmarrësve

11 Enti Shtetëror i Statistikave i Republikës së Maqedonisë së Veriut [https://www.stat.gov.mk/IndikatorITTS\\_en.aspx?id=6](https://www.stat.gov.mk/IndikatorITTS_en.aspx?id=6) (qasja e fundit: 21.08.23).

12 “A ua ka vjedhur dikush pasurinë apo ju ka plaçkitur gjatë vitit të kaluar?” (CV1); “A ka kërcënuar dikush sigurinë tuaj gjatë vitit të kaluar?” (CV2); “A ju ka fyer apo sulmuar dikush në mënyrë verbale gjatë vitit të kaluar?” (CV3); “A ju ka sulmuar dikush fizikisht (me përjashtim të plaçkitjes) pa u shkaktuar lëndime trupore gjatë vitit të kaluar?” (CV4); “A ju ka sulmuar dikush fizikisht (me përjashtim të plaçkitjes) duke ju shkaktuar lëndime trupore gjatë vitit të kaluar?” (CV5); “A ju ka sulmuar apo përdhunuar dikush seksualisht gjatë vitit të kaluar?” (CV6); “A ju ka privuar dikush në mënyrë të paligjshme nga liritë tuaja gjatë vitit të kaluar?” (CV7); “A ua ka dëmtuar dikush pronën tuaj gjatë vitit të kaluar?” (CV8); “A jeni prekur nga dikush që ka përdhosur një varr gjatë vitit të kaluar?” (CV9); “A jeni prekur nga dikush që ka penguar ose shqetësuar një tubim publik gjatë vitit të kaluar?” (CV10); “A ju është refuzuar ndihma mjekësore kur ju është dashur, gjatë vitit të kaluar?” (CV11).

13 Sipas Kodit penal të ndryshuar së fundi të Republikës së Maqedonisë së Veriut, njëmbëdhjetë kategoritë e shkeljeve mbulohe nga: Lëndimi trupor (neni 130); Plagosje e rëndë trupore (neni 131); Heqja e paligjshme e lirisë (neni 140); Kërcënim i sigurisë (neni 144); Pengimi ose shqetësimi i tubimit publik (neni 155); Përdhunimi (neni 186); Mosdhënia e ndihmës mjekësore (neni 208); Vjedhja (neni 236); Plaçkitja (neni 237); Dëmtimi i objekteve të tjerëve (neni 243); Vepra e dhunës (neni 386); Përdhosja e një varri (neni 400).


raportuan se kishin përjetuar të paktën një nga të njëmbëdhjetë llojet e krimit. Megjithatë, dallimi zvogëlohet dukshëm për pjesëmarrësit e vitit 2023 nga tetëmbëdhjetë komunat e hulumtimit të vitit 2018 - 28% në vitin 2023, megjithëse dallimi i dukshëm i mbetur tregon një ndryshim të vogël midis dy hulumtimeve për njëmbëdhjetë kategoritë e kundërvajtjeve të kombinuara kur gjykohet nga standardet e probabilitetit statistikor.

## LLOJET E KRIMEVE TË PËRJETUARA

### Sulme verbale

Një sulm verbal i një forme ose një tjetre ishte lloji më i mundshëm i viktimizimit i raportuar nga të anketuarit në 2018 dhe 2023. Të gjithë të anketuarit u pyetën “A ju ka fyer apo sulmuar dikush në mënyrë verbale gjatë vitit të kaluar?”. Fyerjet përfshihen në veprën penale të “Veprave të dhunës” (neni 386) të Kodit penal (i ndryshuar në 2018), i cili përcakton se: “Kushdo që keqtrajton, fyen ashpër, rrezikon sigurinë ose kryen dhunë të ashpër ndaj tjetrit dhe me këtë shkakton ndjenjë pasigurie, kërcënimi ose frike në publik, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.” Nuk është e mundur të përcaktohet se sa të anketuar janë fyer “ashpër” (pragu i fyerjes siç përcaktohet në kodin penal) sepse mënyra e fyerjeve nuk u pyet në hulumtim. Sidoqoftë, duke përdorur masën e gjerë të pyetjes së hulumtimit për fyerjen ose sulmin verbal, mbi 1 në 20 (7.8%) të të anketuarve të vitit 2023 thanë se kishin përjetuar një fyerje, ku disa fyerje ndoshta mund të llogariten si krime, duke u rritur në 1 në 10 (10.1%) për pjesëmarrësit e hulumtimit të vitit 2023 nga komunat e hulumtimit të vitit 2018 krahasuar me 11.7% nga anketa e vitit 2018 (Figura 1). Për sa i përket probabilitetit statistikor, megjithatë, ndryshimi i vogël i dukshëm i mbetur nuk paraqet një ndryshim ndërmjet dy valëve të hulumtimit.

Figura 1: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën fyerje, sulm verbal ose kërcënim për sigurinë në 12 muajt e fundit



Kërcënimet në mënyrë specifike janë të përfshira me veprën penale “Kërcënimi i sigorisë” (neni 144) sipas Kodit penal. Aty thuhet se: “Kushdo që kërcënon sigurinë e tjetrit, duke kërcënuar seriozisht të sulmojë jetën ose trupin e tij ose jetën ose trupin e një personi të afërt me të, do të gjobet ose dënohet me burgim prej gjashtë muajsh.” Në hulumtim nuk u pyet serioziteti i cilitdo kërcënim të përjetuar. Në përgjithësi, të gjithë të anketuarit u pyetën: “A ju ka kërcënuar dikush sigurinë gjatë vitit të kaluar?”. Duke përdorur këtë masë të gjerë, një pjesë e vogël, 1 në 40 të anketuar në vitin




2023 vunë re se kishin përjetuar një kërcënim të mundshëm kriminal. Shkalla e viktimizimit është më e lartë (3.7%) te të anketuarit e vitit 2023 nga komunat e përfshira në hulumtimin e vitit 2018. Por ndryshimi i dukshëm në krahasim me valën e hulumtimit të vitit 2018 në lidhje me përvojën e kërcënimeve nuk dëshmon një ndryshim ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 kur gjykohet sipas standardeve të probabilitetit statistikor.

### **Krimi ndaj pronës**

Kategoria e dytë më e zakonshme e kundërvajtjeve të përjetuara nga të anketuarit përfshin vjedhjen ose plaçkitjen e pronës së tyre, ose dëmtimin e pronës së tyre. Sipas Kodit penal (i ndryshuar në v. 2018), këto kundërvajtje mbulohen nga veprat penale “Vjedhja me thyerje” (neni 236), “Plaçkitje” (neni 237) dhe “Dëmtimi i gjësendeve të tjerëve” (neni 243). Përafërsisht 1 në 20 të anketuar në valën e vitit 2023 të hulumtimit kanë përjetuar të paktën një nga këto lloje të krimet (Figura 2). Në rastin e vjedhjes ose plaçkitjes së pronës, ka një rënie të dukshme të mundshme të shkallës së mundshme të viktimizimit midis dy anketave, pasi pothuajse 1 në 10 të anketuar në vitin 2018 kanë thënë se pasuria e tyre u ishte vjedhur ose plaçkitur në 12 muajt e mëparshëm. Rënia e vogël në shkallën e dëmtimit të pronës nuk dëshmon një ndryshim ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 kur gjykohet nga standardet e probabilitetit statistikor.

*Figura 2: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën një krim pronësie në 12 muajt e fundit*



### **Refuzimi i ndihmës mjekësore**

Sipas nenit 208 të Kodit penal (paragrafi 1): “Mjeku ose çdo punëtor tjetër shëndetësor që, në kundërshtim me detyrën e tij, nuk i jep ndihmë të menjëhershme mjekësore një personi, jeta e të cilit është në rrezik ose nëse krimi është kryer nga urrejtja, do të gjyketet ose dënohet me burgim deri në një vit”.

*Figura 3: Përqindjet e të anketuarve refuzuan ndihmën mjekësore kur ishte e nevojshme të paktën një herë në 12 muajt e fundit*




Pak më shumë se 1 në 20 (5.5%) të të anketuarve në valën e vitit 2023 të hulumtimit nga komunat e përfshira të vitit 2018 dhe një përqindje identike nga vala e vitit 2018, treguan se atyre u ishte refuzuar ndihma mjekësore kur kjo ka qenë e nevojshme në 12 muajt e mëparshëm (Figura 3). Përderisa Kodi penal i referohet refuzimit të ndihmës mjekësore për një person, jeta e të cilit është në rrezik, të gjithë të anketuarit në hulumtim u pyetën më gjerësisht: “A ju është refuzuar ndihma mjekësore kur keni pasur nevojë, gjatë vitit të kaluar?”. Në lidhje me përfshirjen e nenit për kryerje të veprës penale “nga urrejtja”, të anketuarit që treguan se u ishte refuzuar ndihma mjekësore u pyetën më tej për ndonjë motiv të perceptuar të njëanshmërisë pas kundërvajtjes së mundshme - siç diskutohet në pjesën tjetër të këtij raporti.

### ***Sulmet fizike dhe seksuale***

Të gjithë të anketuarit në hulumtim u pyetën: “A ju ka sulmuar dikush fizikisht gjatë vitit të kaluar (me përjashtim të plaçkitjes) pa shkaktuar lëndime trupore?”, dhe “A ju ka sulmuar dikush fizikisht gjatë vitit të kaluar (me përjashtim të plaçkitjes) duke ju shkaktuar lëndime trupore?”. Sulmet fizike me ose pa lëndime janë të jashtëligjshme nga nenet e ndryshme të Kodit penal, duke përfshirë: “Lëndimi trupor” (neni 130), “Lëndimi i rëndë trupor” (neni 131) dhe “Vepër dhune” (neni 386).

Figura 4: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën një sulm fizik ose seksual në 12 muajt e fundit




Të anketuarit u pyetën më tej: “A ju ka sulmuar apo përdhunuar dikush seksualisht gjatë vitit të kaluar?”. Vepra penale përdhunim është përfshirë në nenin 186 të Kodit penal ndërsa sulmi seksual nga disa dispozita të Kodit. Kodi penal specifikon gjithashtu veprat penale seksuale ndaj fëmijëve, megjithëse këto nuk ishin temë në hulumtim pasi të anketuarit e synuar ishin të moshës 15 vjeç e më lart.

Veçanërisht, shumë pak nga të anketuarit e hulumtimit raportuan se kanë qenë të sulmuar fizikisht, me ose pa lëndime rezultuese, ose të sulmuar seksualisht (Figura 4). Krahas disa dallimeve të vogla të dukshme, sipas standardeve të probabilitetit statistikor nuk ka ndryshim në shkallët e mundshme të viktimizimit ndërmjet viteve 2018 dhe 2023.

### Privimi i lirisë

Mbajtja e paligjshme, privimi ose kufizimi i lirisë së lëvizjes së personave është përcaktuar nga neni 140 i Kodit penal. Të gjithë të anketuarit në hulumtim u pyetën në përputhje me rrethanat: “A ju ka privuar dikush në mënyrë të paligjshme nga liria të paktën një herë në 12 muajt e fundit

Figura 5: Përqindjet e të anketuarve të privuar në mënyrë të paligjshme nga liria të paktën një herë në 12 muajt e fundit



Përkatesisht, vetëm një pjesë shumë e vogël e të anketuarve në valët e hulumtimit të vitit 2023 dhe 2018 deklaruan se ishin privuar në mënyrë të paligjshme nga liria në 12 muajt e mëparshëm (Figura 5). Shkallët e viktimizimit për vitin 2018 dhe 2023 nuk ndryshojnë nga standardet e probabilitetit statistikor pavarësisht ndryshimit të vogël të dukshëm.

### Viktimizimi i tërthortë

Secila nga kategoritë e kundërvajtjeve të diskutuara deri këtu përfshin viktimizimin e drejtpërdrejtë të personave ose pronës së tyre. Dy kundërvajtje të tjera të pyetura në hulumtim mund të konsiderohen se përfshijnë “viktimizimin e tërthortë” ku personat janë të prekur në mënyrë të tërthortë nga veprime që nuk ndërmerren kundër tyre personalisht ose kundër pasurisë së tyre personale. Në hulumtim u përfshinë dy lloje të tilla të kundërvajtjeve. E para është vepër penale “Përdhosje e varrit” (neni 400). Të gjithë të anketuarit u pyetën: “A jeni prekur nga dikush që ka përdhosur një varr gjatë vitit të kaluar?”. Lloji i dytë i kundërvajtjes ku është pyetur viktimizimi i tërthortë në lidhje me krimin “Pengimi ose shqetësimi i një tubimit publik” (neni 155). Sipas Kodit penal kjo përfshin parandalimin ose shqetësimin e “thirrjes ose organizimit të tubimit publik paqësor... me forcë, kërcënim serioz, mashtrim ose në ndonjë mënyrë tjetër.” Për këtë lloj kundërvajtjeje, të gjithë të anketuarit u pyetën: “A jeni prekur nga dikush që ka penguar ose shqetësuar një tubim publik gjatë vitit të kaluar?”.

Qëllimi i këtyre pyetjeve në lidhje me viktimizimin e tërthortë ishte për të fituar pasqyrë të kundërvajtjeve të mundshme të mëtejshme që ndonjëherë përfshijnë motivimin nga njëanshmëria që nuk janë të nënshtruara për t'u përfshirë në hulumtimet e viktimizimit për shkak të krimit të popullsisë, sepse ato nuk përfshijnë viktimizimin e drejtpërdrejtë ndërpersonal të të anketuarve ose pronës së tyre personale. Sidoqoftë, ndriçimi i paraqitjes së tyre është i rëndësishëm pasi krime të tilla mund të kenë një ndikim të mundshëm të tërthorë mbi personat duke nxitur një ndjenjë pasigurie.

Figura 6: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar viktimizim mëkëmbës të pakeën një herë në 12 muajt e fundit



Përafërsisht 1 në 10 të anketuar nga komunat e përfshira të vitit 2018 në valën e hulumtimit të vitit 2023 deklaruan se ishin prekur nga përdhosja e një varri në 12 muajt e mëparshëm (Figura 6). Ky proporcion është pak më i vogël se ai i vitit 2018, megjithatë jo statistikisht i ndryshëm. Përqindje shumë më të vogla të të anketuarve në vitin 2023 deklaruan se ishin prekur nga pengimi ose shqetësimi i një tubimi publik, ndërsa statistikisht, kjo është një rënie e mundshme krahasuar me valën e hulumtimit të vitit 2018.

---

## **KONKLUZIONE: KRAHASIMI I SHKALLËVE TË PËRGJITHSHME TË VIKTIMIT PËR SHKAK TË KRIMIT PËR VITIN 2018 DHE 2023**

---

Kjo pjesë e parë e konstatimeve të hulumtimit në lidhje me viktimizimin e mundshëm për shkak të krimit në përgjithësi zbulon një ngjashmëri të habitshme në shkallët e viktimizimit për vitet 2018 dhe 2023. Nuk është e qartë se ka ndonjë ndryshim të mprehtë në konstatimet ndërmjet dy valëve të hulumtimit. Megjithatë, kur shkallët e përgjithshme të mundshme të viktimizimit nga krimi të merren parasysh për të gjitha krimet e kombinuara, ka indikacione për një rënie të vogël midis vitit 2018 dhe 2023. Në rastin e krimeve specifike të pyetura në hulumtim, në shikim të parë, shkallët e viktimizimit për shumicën duket se kanë rënë shumë pak që nga viti 2018, por në shumicën e rasteve dallimet nuk dëshmojnë ndryshim kur gjykojnë nga standardet e probabilitetit statistikor. Pjesa tjetër e këtij raporti vazhdon krahasimin ndërmjet dy valëve të hulumtimit në lidhje me viktimizimin për shkak të krimit nga urrejtja.

# 4. VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA


## SHKALLËT E PËRGJITHSHME TË VIKTIMIZIMIT PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA

Duke përdorur klasifikimin e krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja të përshkruar në pjesën “Dizajni i hulumtimit” të këtij raporti, pak më pak se një në dhjetë (8.5%) të anketuar në hulumtimin e vitit 2023 thanë se kishin qenë viktimë e një forme të krimit ose incidentit të mundshëm nga urrejtja në 12 muajt e mëparshëm. Shkalla e viktimizimit rritet në 14.7% për pjesëmarrësit e vitit 2023 si grup nga komunat e përfshira në hulumtim të vitit 2018. Është shumë afër 15.2% të pjesëmarrësve të hulumtimit të vitit 2018 të viktimizuar nga krime ose incidente të mundshme nga urrejtja, ndërsa kur gjykohet nga standardet e probabilitetit statistikor nuk përfaqëson një ndryshim në krimin e mundshëm nga urrejtja ose shkallën e viktimizimit të incidenteve ndërmjet dy valëve të hulumtimit.

## VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA DHE INCIDENTET SIPAS LLOJIT TË KRIMIT

Shkalla e viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja dhe nga incidentet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis llojeve të ndryshme të krimit të përfshira në hulumtim (Figura 7). Lloji më i zakonshëm i krimit ose incidentit të mundshëm nga urrejtja të përjetuar nga të anketuarit përfshinte ndonjë formë të fyerjes. Ndërsa treguesit e dëshmimeve të shumta të krimeve do të jenë të dukshëm për personat e prekur - siç janë kërcënimi, sulmi fizik, vjedhja dhe dëmtimi i pronës, dëmtimi dhe përdhosja e varreve, ose pengimi ose prishja e një tubimi publik - treguesit e një fyerjeje penale nuk do të jenë aq të dukshëm. Siç theksohet në pjesën e mëparshme të këtij raporti, fyerjet janë të jashtëligjshme sipas “Veprave të dhunës” (neni 386 i Kodit penal [i ndryshuar në vitin 2018]) në rrethana kur një person “fyer ashpër” një tjetër. Megjithatë, siç theksohet gjithashtu, anketa nuk pyeti për mënyrën ose intensitetin e fyerjeve dhe për këtë arsye nuk mund të përcaktohet se sa fyerje “të ashpra” u përfshinë. Prandaj, është mjaft e mundur që shumë nga fyerjet e motivuara nga njëanshmëria të shënuara nga të anketuarit të përbëjnë incidente të pacivilizuara sesa krime sipas ligjit.

*Figura 7: Përqindjet e të anketuarve që kanë përjetuar të paktën një krim ose incident të mundshëm të urrejtjes në 12 muajt e fundit sipas llojit të krimit*



Të qenit i prekur nga dëmtimi ose përdhosja e një varri, ishte krimi ose incidenti i dytë më i shpeshtë i mundshëm nga urrejtja i përjetuar nga të anketuarit në hulumtim. Ndërsa “të qenit i prekur” nuk është vetë krimi, ai shërben si një tregues i dobishëm, pasi çdo person i prekur tregon për ndodhjen e një krimi të përcaktuar nga Kodi penal.

Në përgjithësi, kur krahasohen valët e hulumtimit të vitit 2018 dhe 2023, nuk ka një model të vetëm të dukshëm të ndryshimit në lidhje me shkallët e motivimit nga njëanshmëria të perceptuar sipas kategorisë së krimit - siç do të pritej duke pasur parasysh se nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm midis viteve 2018 dhe 2023 në shkallën e përgjithshme të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit nga urrejtja dhe nga incidentet. Ndërsa ka një rënie të dukshme të shkallës së fyerjeve të motivuara nga njëanshmëria që nga viti 2018, dallimet e tjera të dukshme ose nuk dëshmojnë një ndryshim midis dy hulumtimeve kur gjykohen nga standardet e probabilitetit statistikor, ose numri i të anketuarve është shumë i vogël për krahasim të besueshëm.

## NUMRI I KRIMEVE DHE INCIDENTEVE NGA URREJTJA


Duke pasur parasysh se valët e vitit 2018 dhe 2023 të hulumtimit të krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut ndryshojnë për sa i përket numrit të të anketuarve dhe numrit të komunave të përfshira në hulumtim, nuk do të ishte e dobishme të krahasohej numri aktual i krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja të shënuara nga të anketuarit në të dy valët. Sidoqoftë, është udhëzuese të bëhet një krahasim midis numrave të hulumtimit të vitit 2023 dhe shifrave zyrtare dhe të OJQ-ve. Krahasimi tregon shpërndarjen e vërtetë të krimeve dhe incidenteve nga urrejtja përtej këtyre shifrave.

Sipas të dhënave të publikuara nga Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR), vetëm 22 krime të urrejtjes janë regjistruar nga policia në Maqedoninë e Veriut për vitin 2021<sup>14</sup>- viti më i fundit për të cilin janë në dispozicion të dhënat e publikuara (me 125

<sup>14</sup> ODIHR vëren se: “22 rastet e raportuara nga policia përfshinin 21 kryerës. Shifrat mund të përfshijnë raste të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, të cilat bien jashtë përkufizimit të krimit nga urrejtja të OSBE-së.” <https://hatecrime.osce.org/north-macedonia>

ndjekje penale atë vit).<sup>15</sup> Ky numër është një rënie nga 33 incidentet e regjistruara në vitin 2018.<sup>16</sup> Të dhënat nga burimet joqeveritare tregojnë një numër më të madh të krimeve për shkak të urrejtjes. Komiteti i Helsinkit i Maqedonisë së Veriut për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar gjithsej 160 (atë që e cilëson si) "krime/incidente nga urrejtja" për vitin 2022, bazuar kryesisht në monitorimin e raporteve të krimit në mediat e shkruara dhe ato elektronike - siç theksohet në raportin e tyre vjetor të krimit nga urrejtja të botuar së fundmi.<sup>17</sup> Për vitin 2018, janë regjistruar 123 incidente të krimit nga urrejtja.<sup>18</sup> Përtej këtyre shifrave, hulumtimi i krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut kap një numër më të lartë të krimeve dhe incidenteve nga urrejtja dhe tregon për shfaqjen e një numri shumë më të lartë akoma. Duke përdorur numra aktualë të paponduar, nga të anketuarit janë përjetuar 172 krime dhe incidente nga urrejtja të paktën një herë në vitin e kaluar (Figura 8), ndërsa disa të anketuar janë viktimizuar më shumë se një herë. Ky numër i përgjithshëm tejkalon numrat e mbledhur nga të dhënat zyrtare dhe të OJQ-ve. Dallimi bëhet i madh kur merret parasysh se 172 krimet dhe incidentet e mundshme nga urrejtja të përfshira në hulumtimet e vitit 2023 bazohen në përvojën e viktimizimit të vetëm 1,614 të anketuarve nga popullsia e Maqedonisë së Veriut - duke treguar një shpërndarje shumë më të lartë të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja nëse merret parasysh e gjithë popullsia.

Figura 8: Numri i krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja sipas llojit të krimit: anketa e vitit 2023



Në të dhënat e krimit nga urrejtja të regjistruara nga policia të publikuara nga ODIHR-ja për Maqedoninë e Veriut, nuk jepen indikacione për llojet e krimeve të përjetuara nga urrejtja. Megjithatë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut vëren se për kundërvajtjet e mundshme të krimit nga urrejtja të regjistruara për vitin 2022, shumica dërrmuese kanë përfshirë dhunë fizike (116 raste të "dhunës" dhe 26 raste të "lëndimit trupor dhe lëndimit të rëndë trupor").<sup>19</sup> Pavarësisht nga kjo, vetëm një pjesë shumë e vogël e krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja të

15 Për të dhënat e prokurorisë, ODIHR vëren se: "Të dhënat për rastet e ndjekura paraqesin lëndë të pezulluara para Gjykatave Themelore; nga numri i përgjithshëm, 118 raste janë pezull para Gjykatës Themelore Penale në Shkup." *ibid.*

16 *ibid.*

17 Natasha Petkovska (2023) *Raporti Vjetor për Krimet nga Urrëjtja në vitin 2022*, Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, faqe 84.

18 Hajdi Shterjova-Simonovich dhe Sanja Barlakovska Velkov (2019) *Raporti Vjetor për Krimet nga Urrëjtja në 2018*, Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, faqe 6.

19 *ibid.*, faqe 85.




raportuara në Hulumtimin e Krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut 2023 ka përfshirë dhunë fizike me ose pa lëndime rezultuese (i njëjtë është rasti për vitin 2018).<sup>20</sup>

## MOTIVIMI NGA NJËANSHMËRIA

Numri i krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja sipas llojit të krimit që sapo u diskutua përcaktohet nga dy faktorë: shpeshësia e shfaqjes së krimit themelor (e diskutuar në pjesën e mëparshme “Viktimizimi për shkak të krimit” të këtij raporti) dhe përqindja e krimeve themelore të perceptuara si të motivuara nga njëanshmëria - me fjalë të tjera, shkalla e viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja për secilin lloj krimi. Këtu është udhëzuese të përqendrohemi në proporcionet e secilit krim themelor që perceptohet të jetë i motivuar nga njëanshmëria.

Për të thjeshtuar krahasimin e shkallës së mundshme të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja midis llojeve të ndryshme të krimit, është e dobishme të përdoren pesë grupimet ose kategoritë kryesore të krimit të përdorura në pjesën e mëparshme të këtij raporti për të diskutuar në përgjithësi viktimizimin për shkak të krimit. Viktimizimi i tërthortë duket të jetë kategoria më e mundshme e krimit për viktimat që të vërejnë motivimin nga njëanshmëria (Figura 9)- megjithëse krimet themelore u shënuan pak më rrallë nga të anketuarit sesa sulmet verbale, të cilat duket se janë krimi ose incidenti tjetër më i mundshëm që perceptohet të jetë i motivuar nga njëanshmëria. Megjithatë, duke përdorur standardet e probabilitetit statistikor, nuk ka dallim midis këtyre shkallëve të motivimit nga njëanshmëria i perceptuar. Krimi ndaj pronës ishte kategoria e krimit ku ishte më pak e mundshme viktimat të vërenin motivimin nga njëanshmëria.

Figura 9: Përqindjet e viktimave që vënë në dukje motivimin nga paragjykimi sipas kategorisë së krimit




Kur krahasohen valët e hulumtimit të vitit 2018 dhe 2023, mund të shihet se nuk ka një model të vetëm të dukshëm të ndryshimit lidhur me shkallët e perceptimit të motivimit nga njëanshmëria sipas kategorisë së krimit. Përqindjet e viktimave të viktimizimit të tërthortë të mundshëm që vënë në dukje motivimin nga njëanshmëria, janë rritur midis dy anketave. Ndryshimet e dukshme për

20 Paul Iganski (2020) *Hulumtimi i viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja*, Shkup: Misioni i OSBE-së në Shkup, faqe 17, figura 3.

kategoritë e tjera të krimit nuk mund të konfirmohen kur gjykohen nga standardet e probabilitetit statistikor.

Motivimi më i shpeshtë nga njëanshmëria i perceptuar nga viktimat e krimit nga urrejtja dhe incidenteve në hulmtim përfshinte paragjykimet në bazë të përkatësisë etnike, racore ose kombëtare. Shumica e krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja përfshinin një paragjykim të tillë (Figura 10). Njëanshmëria fetare ishte motivimi i dytë më i shpeshtë i njëanshmërisë i vërejtur nga viktimat. Më pak se një e katërta e viktimave të mundshme të krimit nga urrejtja në hulmtimin e vitit 2023 besonin se ishte i përfshirë motivimi nga njëanshmëria politik - një rënie e dukshme nga anketa e vitit 2018. Tendenca në rënie e incidenteve me motivim nga njëanshmëria politik është vërejtur edhe nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoninë e Veriut nga monitorimi i tyre mediatik i krimeve dhe incidenteve nga urrejtja.<sup>21</sup> Në drejtim të kundërt, përqindja e viktimave të mundshme të krimit nga urrejtja dhe incidentet që besonin se ishte i përfshirë motivimi nga njëanshmëria për aftësitë e kufizuara, u rrit ndërmjet viteve 2018 dhe 2023. Për më tepër, duke pasur parasysh se një pyetje në lidhje me një paragjykim të tillë iu parashtrua vetëm të anketuarve që deklaruan se kishin aftësi të kufizuara, shkalla e viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja dhe incidentet e personave me aftësi të kufizuara është shumë më e lartë - siç diskutohet më poshtë në pjesën mbi "Viktimizimi dhe karakteristikat e viktimës".

Figura 10: Motivet e paragjyimit të perceptuara nga viktimat e krimit nga urrejtja



Vetëm një pjesë e vogël e përqindjes së krimeve të mundshme nga urrejtja dhe viktimave të incidenteve në të dy valët e hulmtimit besonin se ishte përfshirë njëanshmëria për shkak të orientimit seksual. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se një pyetje në lidhje me një njëanshmëri të tillë iu parashtrua vetëm numrit të vogël të të anketuarve që e identifikuan veten si të ndryshëm nga "heteroseksual", krimi i mundshëm nga urrejtja dhe shkalla e viktimizimit të incidenteve midis të anketuarve homoseksualë, biseksualë dhe "të tjerë" është shumë më e lartë - siç diskutohet më poshtë në pjesën mbi "Viktimizimi dhe karakteristikat e viktimës".

Së fundmi, u parashtrua një pyetje në lidhje me motivimin e perceptuar nga njëanshmëria gjinore, vetëm për viktimat femra të krimit në një modul të veçantë të pyetësorit që përqendrohej në të anketuarit që besonin se kishin përjetuar krim më të rëndë në 12 muajt e mëparshëm. Prandaj, konstatimet nuk janë rreptësisht të krahasueshme me proporcionet relative të motiveve të tjera

21 Natasha Petkovska (2023) Raporti vjetor për krimet nga urrejtja në vitin 2022, Shkup: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, faqe 86.

të njëanshme që sapo u diskutuan. Sidoqoftë, është udhëzuese të theksohet se në pak më shumë se 1 në 8 krime dhe incidente të mundshme nga urrejtja të kapura nga anketa e vitit 2023, femrat e anketuara besonin se krimi ka ndodhur "sepse ato janë gra".

Disa viktimat përmendën përfshirjen e më shumë se një motivimi nga njëanshmëria në krimet dhe incidentet e mundshme që kanë përjetuar. Kjo mund të përcaktohet duke shqyrtuar krimet më të rënda të përjetuara nga të anketuarit që ata besonin se ishin të motivuara nga paragjykimet. Viktimizimi më i zakonshëm i shumëfishtë, ose i ashtuquajtur "ndërsektorial"<sup>22</sup> i njëanshëm, përfshinte prejardhjen fetare të kombinuar me prejardhjen etnike, racore ose kombëtare. Nga 25 krimet më të rënda me një motivim të perceptuar nga njëanshmëria fetar, në 23 raste është perceptuar gjithashtu njëanshmëria etnik, racor ose kombëtar. Megjithatë, ndërlidhja e ngushtë midis njëanshmërisë fetar dhe njëanshmërisë etnike, racore ose kombëtare për krime dhe incidente të motivuara nga feja, zvogëlohet për incidentet nga urrejtja dhe krimet me njëanshmëri etnike, racore ose kombëtare. Një numër viktimash (16) nga krimet më të rënda të mundshme ku u vu re një paragjykim i tillë nuk përmendën njëanshmëri fetare.

## TREGUESIT E NJËANSHMËRISË

Treguesit e njëanshmërisë, për kundërvajtjet e perceptuara si të motivuara nga njëanshmëria, ofrojnë shenja të dukshme të motivimit të mundshëm të kryerësit.<sup>23</sup> Ato përdoren si provë rrethore në ndjekjen penale të krimeve nga urrejtja. Viktima është burimi i parë i provave të tilla. Prandaj, anketa e krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut pyeti të gjitha viktimat e krimeve dhe incidenteve të mundshme të cilat ata i perceptonin si të motivuara nga njëanshmëria, se përse mendonin ashtu. Llojet e ndryshme të krimit tregojnë modele të ndryshme të motivimit të perceptuar nga njëanshmëria - të përcaktuara në pjesën më të madhe nga fakti nëse viktimat dhe shkelësi kanë rënë në kontakt. Numri i viktimave në hulumtim është shumë i vogël për të siguruar një krahasim midis llojeve të krimit me standardet e pranueshme të probabilitetit statistikor. Megjithatë, është udhëzuese të shqyrtohen modelet treguese - të cilat tregohen në Figurën 11. Duke qenë se fokusi është në modelet, jo në numrat, përdoret një hartë nxehtësie.

22 Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (2020) *Të kuptuarit e Nevojave të Viktimave të Krimit nga Urrëjtja*, Varshavë: OSBE ODIHR, faqe 9.

23 Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (2014) *Ndjekja e Krimeve nga Urrëjtja. Një udhëzues praktik*, Varshavë: OSBE ODIHR, faqe 46.

Figura 11. Treguesit e njëanshmërisë për krimet e mundshme nga urrejtja etnike, racore ose kombëtare, 2023

	SULME VERBALE		VIKTIMIZIMI I PËRVETËSUAR		KRIMI NDAJ PRONËS		REFUZIMI I NDIHMËS MJEKËSORE	SULM FIZIK DHE SEKSUAL*	
	Fyerje	Kërcënime për sigurinë	Përdhosja ose dëmtimi i rëndë i varrit	Pengimi ose ndërprerja e tubimit publik	Vjedhja ose plaçkitja e pronës	Dëmtimi i pronës	Refuzimi i ndihmës mjekësore	Sulm fizik pa lëndime	Sulm fizik me lëndime
Çfarë më tha kryerësi, ose fjalët e përdorura nga shkelësi									
Gjestet e kryera nga kryerësi									
Data në të cilën ka ndodhur									
Vendi në të cilin ka ndodhur									
Ka ndodhur edhe më parë									
Prejardhja etnike, racore ose kombëtare e kryerësit									
Gjithsej (nr.)	[22]	[12]	[41]	[10]	[6]	[6]	[8]	[2]	[3]
Të gjitha të pa ponderuara									
Vlerat Proporcionet	0.75-1.00		0.50-0.74		0.25-0.49		0.01-0.24		0

\*Nuk është shënuar asnjë sulm seksual ose heqje lirie si rezultat i paragjyqimeve etnike, racore ose kombëtare nga të anketuarit.

Edhe pse konstatimet mund të trajtohen vetëm në mënyrë indikative, është e qartë se në krimet dhe incidentet e mundshme nga urrejtja ku viktimat dhe kryerësit bien në kontakt, siç janë rastet e sulmit verbal, refuzimi i ndihmës mjekësore dhe sulmet fizike, treguesi më i zakonshëm i njëanshmërisë janë fjalët e përdorura nga shkelësit e ligjit. Viktimat, dëshmitarët, madje edhe bashkëkryerësit, janë të gjitha burime të mundshme të provave të tilla.<sup>24</sup>

## KRYERËSIT

Kur viktimat e krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja pyeten për kryerësit, është e qartë se nuk ka asnjë tip të njëjtë të kryerësit. Për më tepër, në literaturën e politikave të krimit nga urrejtja dhe nga praktikuesit që punojnë kundër krimit nga urrejtja, është e njohur se shumë kryerës janë njerëz shumë të rëndomë të pa asnjë lidhje me grupet ekstremiste<sup>25</sup>. Kjo dëshmohet nga konstatimet nga anketa e krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut pasi viktimat u pyetën për kryerësit e krimeve më të rënda që përjetuan (Tabela 1).

24 ibid., faqe 60.

25 ibid, faqe 22.

Tabela 1. Kryerësit e krimeve dhe incidenteve nga urrejtja dhe krimeve dhe incidenteve të tjera

	Krimi nga urrejtja		Krime të tjera	
	2018	2023	2018	2023
I panjohur	25.2	27.4	22.8	13.9
Nuk e kam parë kryerësin	22.2	6.0	28.5	28.9
Dikush tjetër nga lagjja jote	18.8	8.3	8.7	6.2
Anëtar i familjes suaj	12.3	9.2	3.8	5.6
Dikush tjetër që njeh	11.3	12.2	10.4	9.9
Nëpunës tjetër publik	5.6	6.5	3.9	7.4
Fqinj	4.5	5.9	9.8	9.9
Adoleshent ose grup adoleshentësh	4.1	5.2	2.8	4.1
Dikush nga shkolla ose fakulteti	3.5	3.7	3.6	2.8
Tifoz futbolli/huliganë	3.5	--	0.6	--
Dikush me të cilin punoni/koleg	3.2	7.6	2.3	3.1
Një myshteri, klient ose pacient	2.7	8.0	2.8	1.9
Polic	2.5	1.5	0.7	1.6
Anëtar i një grupi ekstremist	0.4	6.8	--	0.9
Tjetër	0.4	14.8	8.0	15.6
Gjithsej ( të pa ponderuara)	90	60	207	160

Përqindjet e kolonës (përqindjet totale tejkalojnë 100% të përzgjedhjes së mundshme të shumfishtë)

Për viktimat e krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja, modeli i reagimit është i ngjashëm ndërmjet dy valëve të hulumtimit. Përderisa disa kryerës ishin të njohur për viktimat në disa mënyra, personat e panjohur ishin lloji i vetëm më i zakonshëm i kryerësit. Anëtarët e grupeve ekstremiste ishin rrallë herë të përmendur nga viktimat si kryerës të krimeve dhe incidenteve nga urrejtja.

## KONKLUZIONE: KRAHASIMI I SHKALLËVE TË VIKTIMIZIMIT NGA KRIMI PËR VITIN 2018 DHE 2023

Vala e hulumtimit të vitit 2023 për krimin nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut tregon një shpërndarje shumë më të lartë të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit nga urrejtja sesa sugjerohet nga të dhënat zyrtare dhe ato të OJQ-ve. Situata ishte e njëjtë edhe në vitin 2018. Krahasuar me rënien e vogël të shkallës së përgjithshme të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit në përgjithësi siç u diskutua në pjesën e mëparshme të këtij raporti, konstatimet e paraqitura në këtë pjesë nuk dëshmojnë asnjë ndryshim në shkallën e përgjithshme të krimit të mundshëm nga urrejtja dhe viktimizimi nga incidentet ndërmjet viteve 2018 dhe 2023. Rrjedhimisht, siç do të pritej, megjithëse për disa kategori krimi të përfshira në hulumtim ka ndryshime të dukshme në shkallët e motivimit të perceptuar nga njëanshmëria, nuk ka një model të vetëm të dukshëm të ndryshimit. Modeli i motiveve nga njëanshmëritë e ndryshme të perceptuara për krimet dhe incidentet nga urrejtja është gjithashtu i ngjashëm ndërmjet valëve të hulumtimit në 2018 dhe 2023. Megjithatë, ka një ndryshim të dukshëm nga anketa e vitit 2018. Përqindja e krimeve të urrejtjes dhe incidenteve me një paragjykim të perceptuar politik është ulur. Paragjykimet në bazë të prejardhjes etnike, racore ose kombëtare, mbeten motivimi më i zakonshëm i perceptuar nga njëanshmëria.

# 5. VIKTIMIZIMI SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË VIKTIMËS

## SHKALLA E PËRGJITHSHME E VIKTIMIZIMIT SIPAS GJINISË

Të anketuarat femra kishin pak më shumë gjasa se meshkujt të raportonin se kishin qenë viktimë e ndonjë krimi të mundshëm në 12 muajt para hulumtimit (25.0% e femrave: 22.9% e meshkujve. Shkalla e përgjithshme e viktimizimit rritet (në 28.2%) për pjesëmarrëset femra të hulumtimit të vitit 2023 si grup nga komunat e hulumtimit nga viti 2018, e cila është pak më e ulët se shkalla (28.7%) për pjesëmarrësit meshkuj si grup nga komunat e hulumtimit nga viti 2018. Në hulumtimin e vitit 2018, proporcione më të larta - 35,4% e meshkujve, 30,7% e femrave - kanë raportuar se kanë qenë viktimë e ndonjë krimi në 12 muajt para hulumtimit.

Megjithatë, asnjë nga dallimet midis femrave dhe meshkujve në shkallët e përgjithshme të viktimizimit të mundshëm nga krimi, nuk mund të konfirmohen, për të dy valët e hulumtimit, kur gjykohet sipas standardeve për probabilitet statistikor. Po kështu, rënia e vogël e dukshme e shkallës së viktimizimit për femrat që nga viti 2018 nuk dëshmon ndryshim kur gjykohet nga standardet për probabilitet statistikor. Megjithatë, rënia e shkallës së përgjithshme të viktimizimit për meshkujt që nga viti 2018 mund të konfirmohet nga standardet për probabilitet statistikor.

Shkurtimisht, hulumtimi i vitit 2023 nuk tregon ndonjë dallim në shkallën e përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit midis femrave dhe meshkujve. Megjithatë, tregon një ulje të mundshme të shkallës së përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit për meshkujt krahasuar me hulumtimin e vitit 2018.

## GJINIA DHE VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA


Nuk ka dallim të dukshëm midis femrave dhe meshkujve në valën e hulumtimit të vitit 2023 për shkallën e përgjithshme të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja. Një në dymbëdhjetë femra (8.5%) dhe meshkuj (8.6%) raportuan se kanë qenë viktimë e të paktën një krimi ose incidenti të mundshëm nga urrejtja në 12 muajt para hulumtimit. Po kështu, nuk u gjet asnjë ndryshim i dukshëm midis femrave dhe meshkujve në shkallën e përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja në hulumtimin e vitit 2018. Megjithatë, shkallët e përgjithshme të viktimizimit për shkak të krimit nga urrejtja në vitin 2018 (femra 15.1%: meshkuj 15.2%) ishin pothuajse dy herë më të larta se në vitin 2023. Por dallimet e vogla në shkallët sipas gjinisë midis dy anketave janë larguar për pjesëmarrësit në hulumtimin e vitit 2023 nga komunat e përfshira të vitit 2018 (femra 13.7%: meshkuj 15.9%) kur gjykohen nga standardet e probabilitetit statistikor.

Për ta përmbledhur, nuk ka dallim të dukshëm midis femrave dhe meshkujve në shkallën e përgjithshme të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja në valën e hulumtimit nga viti 2023. Situata ishte e njëjtë edhe në vitin 2018. Gjithashtu nuk ka ndryshim të dukshëm në shkallët e viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja për femrat dhe meshkujt ndërmjet dy hulumtimeve.

## MOSHA DHE VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT

Në valën e hulumtimit të vitit 2018, të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa se të anketuarit më të vjetër të raportonin se kishin qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm në 12 muajt e mëparshëm, siç mund të shihet kur të anketuarit kategorizohen në tre grupmosha (Figura 12). Është rasti i njëjtë si për meshkujt ashtu edhe për femrat.

Figura 12: Viktimizimi i krimit sipas grup moshës




Sidoqoftë, lidhja midis rritjes së moshës dhe rënies së viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nuk është e dukshme për të gjithë të anketuarit e vitit 2023 si grup, ose për të anketuarit brenda atij grupi nga komunat e përfshira të vitit 2018. Kjo mund të lidhet me një shkallë më të madhe të viktimizimit të mundshëm nga krimi dhe incidentet midis personave me aftësi të kufizuara në hulumtimin e vitit 2023 dhe një përqindje më të lartë të 55-vjeçarëve dhe më lartë, që kanë një sëmundje të gjatë ose aftësi të kufizuara, siç diskutohet më poshtë.

## VIKTIMIZIMI NGA KRIMI NDAJ MOSHËS DHE KRIMI NGA URREJTJA

Viktimizimi i krimit nga urrejtja ndodh në të gjitha grupmoshat e të anketuarve. Megjithatë, në vitin 2018, të anketuarit më të rinj kishin më shumë gjasa se të anketuarit më të vjetër të raportonin se kishin qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm nga urrejtja në 12 muajt e mëparshëm (Figura 13).

Figura 13: Viktimizimi i krimit nga urrejtja sipas grupmoshës



Por, lidhja midis rritjes së moshës dhe rënies së viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit nga urrejtja dhe incidentet nuk është e dukshme për të gjithë të anketuarit e vitit 2023 si grup, ose për të anketuarit brenda atij grupi nga komunat e përfshira të vitit 2018. Siç është rasti me përvojën e krimit në përgjithësi, kjo mund të lidhet me një shkallë më të madhe të viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja midis personave me aftësi të kufizuara në hulumtimin e vitit 2023 dhe një përqindje më të lartë të 55-vjeçarëve dhe më lartë, që kanë një sëmundje të gjatë ose aftësi të kufizuara, siç diskutohet më poshtë.

## AFTËSIA E KUFIZUAR DHE SHKALLA E VIKTIMIZIMIT

Pak më shumë se një në tetë të anketuar (13.3%) në valën e hulumtimit të vitit 2023 thanë se kishin një gjendje shëndetësore fizike ose mendore ose sëmundje që zgjaste ose pritej të zgjaste për 12 muaj ose më shumë. Kjo rritet në pothuajse një në pesë të anketuar (19.1%) nga komunat e përfshira të vitit 2018 në valën e hulumtimit të vitit 2023. Kjo është pak më shumë se 18.0% e pjesëmarrësve me aftësi të kufizuara në vitin 2018. Megjithatë, ndryshimi nuk dëshmon ndonjë ndryshim ndërmjet dy hulumtimeve kur gjykohet nga standardet e probabilitetit statistikor.

Në të dy hulumtimet, të anketuarit me një gjendje ose sëmundje të shëndetit fizik ose mendor afatgjatë kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm në 12 muajt e mëparshëm krahasuar me ata pa aftësi të kufizuara:

- ◆ (45.4%: 20.7%) për të gjithë të anketuarit në valën e hulumtimit të vitit 2023.
- ◆ (53.2%: 22.6%) për të anketuarit nga komunat e përfshira të vitit 2018 në valën e hulumtimit të vitit 2023.
- ◆ (37.9%: 31.9%) për të anketuarit nga vala e hulumtimit të vitit 2018.<sup>26</sup>

26 Ky ndryshim i dukshëm nuk është i konfirmuar kur gjykohet nga standardet e probabilitetit statistikor.



Është e dukshme se një përqindje më e lartë e të anketuarve me aftësi të kufizuara nga komunat e përfshira të vitit 2018 në valën e vitit 2023 të hulumtimit kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm në 12 muajt e mëparshëm krahasuar me të anketuarit me aftësi të kufizuara në valën e vitit 2018 të hulumtimit - që tregon një ndryshim ndërmjet dy valëve të hulumtimit.

## **AFTËSIA E KUFIZUAR DHE VIKTIMIZIMI PËR SHKAK TË KRIMIT NGA URREJTJA**

Pothuajse një e katërta-24.2% e të gjithë të anketuarve në hulumtimin e vitit 2023 të cilët thanë se kishin një gjendje ose sëmundje të shëndetit fizik ose mendor që zgjaste ose pritej të zgjaste për 12 muaj kishin përjetuar një krim ose incident të mundshëm nga urrejtja në 12 muajt e mëparshëm krahasuar me 6% të të anketuarve pa aftësi të kufizuara. Në rastin e të anketuarve nga komunat e përfshira të vitit 2018 në valën e hulumtimit të vitit 2023, shkalla e krimit nga urrejtja dhe viktimizimi nga incidentet rritet në 34.4% krahasuar me 18.4% në vitin 2018 ndërsa, siç është rasti me viktimizimin nga krimi për personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi, kjo tregon një ndryshim ndërmjet dy valëve të hulumtimit.

## **PËRKATËSIA ETNIKE DHE VIKTIMIZIMI**

Numri i të anketuarve nga pakicat etnike dhe kombëtare në valën e hulumtimit të vitit 2023 është shumë i vogël për të bërë krahasime të besueshme midis të gjitha grupeve në lidhje me përvojën e tyre të raportuar të krimit dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja si dhe krimeve pa një motivim të perceptuar të njëanshmërisë (Tabela 2). I njëjti kufizim ndikon në krahasimin ndërmjet valëve të hulumtimit të vitit 2018 dhe 2023. I vetmi krahasim i besueshëm - kur merren parasysh numrat e të anketuarve - është për të anketuarit shqiptarë dhe maqedonas:

- ◆ Në valën e vitit 2023, krahasuar me të anketuarit shqiptarë, pothuajse dyfishi i përqindjes së të anketuarve maqedonas nga komunat e përfshira në vitin 2018 kishin përjetuar të paktën një krim ose incident të mundshëm në 12 muajt e mëparshëm (shqip 17.9%: maqedonas 35.40%).
- ◆ Për komunat e tjera në vitin 2023, kishte shumë pak ndryshim në shkallët e viktimizimit midis të anketuarve shqiptarë dhe maqedonas (shqiptar 21.8%: maqedonas 20.2%).
- ◆ Në rastin e viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja, krahasimi i hulumtimit të vitit 2018 me të anketuarit e vitit 2023 si grup nga komunat e përfshira të vitit 2018, tregon se shkallët e viktimizimit kanë mbetur statike ndërmjet dy valëve të hulumtimit (Dallimet e vogla vëzhguese nuk konfirmohen nga standardet e probabilitetit statistikor).
- ◆ Duke bërë të njëjtin krahasim ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 për viktimizimin e mundshëm nga krimi në përgjithësi, është e qartë se ka pasur një rënie të shkallës së viktimizimit për të anketuarit shqiptarë si grup që nga viti 2018, por për të anketuarit maqedonas si grup shkalla ka mbetur statike.

Tabela 2: Etnia dhe viktimizimi i mundshëm

	Hulumtimi i vitit 2018			Komunat nga viti 2018 në hulumtimin e vitit 2023			Komunat e tjera të përfshira në hulumtimin e vitit 2023		
	Krimi nga urrejtja	Të gjitha aktet e krimit	n	Krimi nga urrejtja	Të gjitha aktet e krimit	n	Krimi nga urrejtja	Të gjitha aktet e krimit	n
Shqiptar	9.9	25.0	592	10.6	17.9	187	7.4	21.8	181
Boshnjak	25	32.0	[29]	50.0	75.0	[5]	80.0	80.0	[9]
Maqedonas	17.1	36.7	693	16.1	35.4	246	3.2	20.2	844
Romë	46.2	61.5	[37]	14.3	14.3	[10]	28.6	41.2	[33]
Serbë	22.2	40.0	[44]	14.3	25.0	[12]	41.7	75.0	[14]
Turq	10.9	36.4	58	26.3	47.4	[15]	2.6	13.2	[32]
Vlleh	16.7	50.0	[31]	0.0	0.0	[3]	0.0	0.0	[9]

## RELIGJIONI DHE VIKTIMIZIMI

Në vitin 2018, të anketuarit e krishterë kishin më shumë gjasa sesa të anketuarit myslimanë të raportnin se kishin qenë viktimë e ndonjë krimi ose incidenti në 12 muajt e mëparshëm (36% e të krishterëve: 28.1% e myslimanëve). Po kështu, të anketuarit e krishterë kishin më shumë gjasa sesa të anketuarit myslimanë të raportnin se kishin qenë viktimë e krimit të mundshëm nga urrejtja në 12 muajt e mëparshëm (16.8% e të krishterëve: 12.7% e myslimanëve). Në rastin e viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja, krahasimi i hulumtimit të vitit 2018 me të anketuarit e vitit 2023 si grup nga komunat e përfshira të vitit 2018, tregon se shkallët e viktimizimit si për të anketuarit të krishterë ashtu edhe myslimanë si grupe kanë mbetur statike ndërmjet dy valëve të hulumtimit (16.1% e të krishterëve: 12.4% e myslimanëve). Megjithatë, për viktimizimin e mundshëm nga krimi në përgjithësi, përderisa shkalla e viktimizimit ka mbetur statike për të anketuarit e krishterë si grup, ka pasur një rënie të shkallës së viktimizimit për të anketuarit myslimanë si grup që nga viti 2018 (34.4% e të krishterëve: 20.9% e myslimanëve).

## ORIENTIMI SEKSUAL DHE VIKTIMIZIMI

Shumica dërrmuese e të anketuarve në të dy valët e hulumtimit thanë se janë heteroseksualë - kur u pyetën për orientimin e tyre seksual (Tabela 2). Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve thanë se ata "preferojnë të mos e thonë". Në valën e vitit 2018, 20 nga 28 të anketuarit që thanë se janë ose biseksualë, homoseksualë ose aseksualë, vunë në dukje se kanë qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm brenda vitit të kaluar, ndërsa 17 thanë se kishin qenë viktimë e një krimi ose incidenti të mundshëm nga urrejtja. Këto shkallë janë shumë më të larta se shkallët për të anketuarit heteroseksualë. Në valën e hulumtimit të vitit 2023 vetëm gjashtë të anketuar thanë se ata ose ishin biseksualë ose aseksualë, dhe asnjë nuk zgjodhi "homoseksual". Ky numër shumë i ulët parandalon krahasimin ndërmjet dy valëve të hulumtimit.

*Tabela 3: Të anketuarit sipas orientimit seksual 2018 dhe 2023*

	2018 %	2018 n	2023 %	2023 n
Heteroseksual	88.6	1340	92.9	1499
Biseksual	0.6	9	0.2	2
Homoseksual	0.4	8	0.0	0
Aseksual	1.7	11	0.2	4
Tjetër	0.6	10	3.4	54
Preferoj të mos e them	8.3	132	3.4	55

# 6. RAPORTIMI NË POLICI

Shumica e pyetjeve në hulumtimin për krimin nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut në lidhje me krimet dhe incidentet policore u parashtruan në modulin që kishte të bënte me krimet më të rënda. Kjo pjesë e raportit paraqet rezultatet nga ato pyetje, me krahasime ndërmjet valëve të hulumtimit në vitin 2018 dhe 2023, ku numri i të anketuarve është i mjaftueshëm për analizë.

## SHKALLA E RAPORTIMIT

Vetëm një e treta -33,6% e të gjitha krimeve më të rënda të shënuara nga viktimat në valën e hulumtimit të vitit 2023 u raportuan në polici krahasuar me 42,1% në vitin 2018. Megjithatë, kjo diferencë hiqet plotësisht për të anketuarit e vitit 2023 si grup nga komunat e përfshira të vitit 2018, pasi 42% e krimeve më të rënda janë raportuar në polici.

Për t'u përqendruar në krimet dhe incidentet nga urrejtja, vetëm më pak se katër në dhjetë (37%) të krimeve më të rënda të perceptuara si të motivuara nga paragjykimet, të përjetuara nga të anketuarit e vitit 2023 si një grup nga komunat e përfshira të vitit 2018, ishin raportuar në polici. Është shumë afër shkallës së raportimit prej 39.8% për krimet më të rënda të perceptuara si të motivuara nga paragjykimet në valën e hulumtimit të vitit 2018 dhe nuk provon një ndryshim kur gjykohet sipas standardeve për probabilitet statistikor.<sup>27</sup>

Përqindjet më të larta të viktimave të krimeve më të rënda që **nuk** ishin të motivuara nga paragjykimet kanë raportuar në polici: 45.7% në 2023, dhe 43.3% në 2018. Megjithatë, ky ndryshim i vogël ndërmjet dy valëve të hulumtimit gjëryhet gjithashtu kur gjykohet nga standardet për probabilitet statistikor, siç janë dallimet e dukshme brenda secilës prej dy valëve të hulumtimit midis viktimave të krimeve dhe incidenteve të motivuara nga paragjykimet dhe të motivuara ndryshe.<sup>28</sup>

## SHKALLA E RAPORTIMIT SIPAS LLOJIT TË KRIMIT

Llojet e ndryshme të krimit tregojnë shkallë të ndryshme të raportimit në polici. Është e dobishme që kjo të kuptohet për të marrë parasysh se si kjo mund të ndikojë në shkallët e raportimit për krimet dhe incidenteve nga urrejtja në krahasim me krimet dhe incidentet pa motivim njëanshmëria, duke pasur parasysh se proporcionet e perceptuara si të motivuara nga njëanshmëria ndryshojnë midis llojeve të ndryshme të krimit.

Viktimat e secilit lloj krimi në modulin kryesor të hulumtimit mbi krimin u pyetën se sa herë e kishin përjetuar krimin në 12 muajt e mëparshëm dhe sa e kishin raportuar në polici. Megjithatë, potenciali për të shqyrtuar shkallët e raportimit për secilin nga llojet e krimit - duke krahasuar krimet dhe incidentet e motivuara nga njëanshmëria me krimet dhe incidentet pa motivim nga njëanshmëria - është i kufizuar nga numri i viktimave në hulumtim. Megjithatë, kjo mund të tejkalohet duke kombinuar të dhënat nga të dy valët e hulumtimit dhe duke përdorur pesë grupet kryesore të krimit për krahasim. Përgjigja më e besueshme për

27 Ndërsa duhet të ushtrohet kujdesi i interpretimit këtu, duke pasur parasysh totalin e vogël (n=31) për krimet më të rënda të perceptuara si të motivuara nga paragjykimet e përjetuara nga të anketuarit e vitit 2023, si një grup nga komunat e vitit 2018, është udhëzuese që gjithashtu të theksohet se edhe nëse totali do të rritej dhjetëfish nuk do të kishte ende një ndryshim statistikisht të rëndësishëm.

28 Po kështu, edhe nëse totali do të rritej dhjetëfish, ende nuk do të kishte ndonjë ndryshim statistikisht të rëndësishëm.

krahasim midis grupeve të krimit është proporcioni i të anketuarve që deklaruan se krimi ose incidenti nuk është raportuar në polici. Konstatimet tregojnë qartë një ndryshim të gjerë në shkallët e raportimit midis kategorive të ndryshme të krimit (Tabela 3). Krimet dhe incidentet që përfshinin refuzimin e ndihmës mjekësore kishin më së paku të ngjarë të raportoheshin në polici. Sulmet verbale - si fyerjet ose kërcënimet - ishin të radhës me më pak gjasa të raportoheshin. Ndryshe, vetëm një pakicë e krimeve ndaj pronës nuk janë raportuar në polici.<sup>29</sup>

*Tabela 4: Viktimat që nuk kanë raportuar krimet ose incidentet që kanë përjetuar në polici sipas motivimit nga njëanshmëria dhe kategorisë së krimit*

Kategoria e krimit	Krimet dhe incidentet nga urrejtja		Krimet dhe incidentet pa perceptim të motivimit nga njëanshmëria		Të gjitha	
	%	n	%	n	%	n
Sulmi verbal	65.8	175	77.8	233	72.3	408
Viktimizimi i tërthortë	11.5	138	27.2	170	19.7	308
Refuzimi i ndihmës mjekësore	91.1*	[49]	94.3*	89	93.2	138
Krimi kundër pronës	18.4*	[48]	28.1*	217	26.7	265
Sulm	45.0*	[29]	51.0*	56	49.3	85

Anketa e Krimit nga Urrejtja në Maqedoninë e Veriut valët e 2018 dhe 2023 të kombinuara  
Përqindjet e rreshtit

\* Dallimi i dukshëm midis krimeve dhe incidenteve nga urrejtja dhe krimeve dhe incidenteve pa një motivim nga njëanshmëria nuk është statistikisht i rëndësishëm.

Përderisa analiza e krimeve dhe incidenteve më të rënda nuk tregon asnjë ndryshim në shkallët e raportimit midis atyre me motivim të perceptuar të njëanshmërisë dhe atyre pa - siç u diskutua më lart, analiza e shkallëve të raportimit për grupimet e veçanta të krimit duke përdorur përgjigjen nga modulin kryesor të hulumtimit mbi krimin, duket se tregon një model të qëndrueshëm: krimet dhe incidentet me një motivim të perceptuar nga njëanshmëria kanë më pak të ngjarë të mos raportohen (me fjalë të tjera, ka më shumë të ngjarë të raportohen) krahasuar me ato pa motivim nga njëanshmëria. Megjithatë, dallimet e dukshme mund të konfirmohen vetëm me standardet e probabilitetit statistikor për sulmet verbale dhe viktimizimin e përvetësuar. Megjithatë, këto konstatime duket se shkojnë kundër urtësisë konvencionale se krimet e urrejtjes "janë ndër krimet më pak të raportuara".<sup>30</sup>

## ARSYET E MOS DENONCIMIT TË KRIMEVE DHE INCIDENTEVE NË POLICI

Një pyetje se përse viktimat nuk i kanë raportuar krimet në polici është përfshirë në modulin e hulumtimit duke u fokusuar në krimet më të rënda të përjetuara nga të anketuarit. Megjithatë, numrat e viktimave të hulumtimit të vitit 2023 që nuk kanë raportuar krimin më të rëndë që kanë përjetuar në polici janë shumë të pakta për krahasime të besueshme me valën e hulumtimit të vitit 2018. Sidoqoftë, është e dobishme të merren parasysh arsyet e dhëna nga të gjitha viktimat, në të dy valët e kombinuara të hulumtimit, të cilët nuk kanë raportuar në polici krimin më të rëndë që përjetuan, duke pasur parasysh numrin më të madh të të anketuarve (Tabela 4).

29 E njëjta gjë duket të jetë rasti për viktimizimin e përvetësuar. Megjithatë, krahasuar me kategoritë e tjera të krimit, një pjesë shumë më e madhe, pothuajse gjysma, e viktimave nga krimi i përvetësuar deklaruan se nuk e dinin nëse ishte raportuar apo jo - ndoshta duke treguar se nuk ishin të sigurt nëse dikush tjetër, siç janë autoritetet e varrezave, e kanë raportuar atë, duke qenë se pyetja e anketës, "Sa nga këto ngjarje janë raportuar në polici?", nuk ka pyetur konkretisht se nëse i anketuari e ka raportuar atë.

30 OSBE ODIHR (2020) *Viktimat e Krimit nga Urrejtja në Sistemin e Drejtësisë Penale. Një Udhëzues Praktik, Varshavë: Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, faqe 43.*

*Tabela 5: Arsyet pse shumica e krimeve të rënda nuk janë raportuar në polici*

	Krimet dhe incidentet nga urrejtja	Krimet dhe incidentet pa perceptim të motivimit nga njëanshmëria	Të gjitha
	%	%	%
Jemi marrë vetë me problemin/ ndihmë nga miqtë e familjes	19.3	22.4	21.5
Nuk kisha besim se policia do të mund të bënte diçka	37.6	18.6	24.5
Shumë e parëndësishme/ nuk ia vlen të raportohet	17.3	19.0	18.4
Është një ngjarje e zakonshme/ vetëm diçka që ndodh	30.7	12.6	18.3
Policia do të angazhohej/ nuk do të ishte e interesuar	12.6	6.3	8.2
Frika e frikësimit nga kryerësit nëse raportohet incidenti	13.1	9.3	10.5
Të shqetësuar për pasojat negative, nëse raportohet	12.7	13.4	13.2
Nuk më pëlqen/kam frikë nga policia/përvojë e mëparshme e keqe me policinë	1.9	9.9	7.4
Shqetësim/ shumë burokraci ose telashe/ skam pasur kohë	7.6	7.5	7.5
Kanë raportuar tek autoritete tjera në vend se në polici	3.0	1.9	2.3
Probleme me lejen e qëndrimit – kështu që nuk mund të raportoj	--	0.8	0.6
Janë përpjekur të raportojnë por policia nuk ishte e interesuar	1.8	0.4	0.8
Nuk kanë raportuar për shkak të vështirësive gjuhësore	--	1.5	1.0
Gjithsej (i pa ponderuar)	89	208	297

Anketa e Krimet nga Urrejtja në Maqedoninë e Veriut valët e 2018 dhe 2023 të kombinuara  
Përqindjet e kolonës (totali tejkalon 100, pasi janë të mundura më shumë përzgjedhje)

Dallohet një ndryshim kryesor në lidhje me arsyet e mos raportimit në krahasimin e viktimave nga krimet dhe incidentet e motivuara nga njëanshmëria me viktimat nga krimet dhe incidentet e motivuara ndryshe. Përmasat e krimeve dhe incidenteve më të rënda të perceptuara si të motivuara nga njëanshmëria për të cilat viktimat deklaruan se "nuk ishin të sigurt se policia do të ishte në gjendje të bënte diçka" dhe është "një ngjarje e zakonshme ose thjesht diçka që ndodh", janë dy herë më të larta se proporcionet e viktimave nga krimet dhe incidentet më të rënda pa motivim nga njëanshmëria që japin të njëjtat arsye. Këto konstatime nuk nënkuptojnë domosdo kritika ndaj policisë - veçanërisht pasi vetëm një pjesë shumë e vogël e viktimave të krimeve dhe incidenteve të motivuara nga njëanshmëria shënuan "mospëlqim ose frikë nga policia" ose "përvojë të keqe të mëparshme nga policia" si arsye për mos raportim. Ata fare mirë mund të shprehin qëndrimin e viktimave që edhe nëse hetohen, policia nuk do të ishte në gjendje të bënte asgjë për arsye të ndryshme.

# 7. NDIKIMI PAS VIKTIMIZIMIT DHE SHQETËSIMI PËR SHKAK TË KRIMIT

Vala e hulumtimit të vitit 2018 për krimin nga urrejtja hulumtoi lloje të ndryshme të ndikimit pas viktimizimit të identifikuar në literaturën e hulumtimit dhe politikave deri më sot - ndikimi social-emocional, psikologjik, psikosomatik dhe i sjelljes - duke krahasuar viktimat e krimeve dhe incidenteve të mundshme që besohet të jenë të motivuara nga paragjykimet me viktimat e krimeve dhe incidenteve të mundshme pa një motivim të tillë të perceptuar. Për secilën nga masat e ndikimit pas viktimizimit, konstatimet treguan se viktimat e krimeve dhe incidenteve nga urrejtja si grup kishin më shumë gjasa të raportnin nivele më të larta të ndikimit sesa viktimat e krimeve të tjera. Megjithatë, shumë nga dallimet e dukshme nuk mund të konfirmoheshin kur gjykoheshin nga standardet e probabilitetit statistikor për shkak të madhësisë së mostrave të pjesëmarrësve në hulumtim.

Vala e hulumtimit të vitit 2023 për krimin nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut gjithashtu matë ndikimin pas viktimizimit nga krimi nga urrejtja krahasuar me ndikimin e krimit pa një motivim të perceptuar nga njëanshmëria. Është e dobishme të shqyrtohen konstatimet e dy valëve të hulumtimit për disa masa kryesore të ndikimit pas viktimizimit ku dallimet midis viktimave të krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja dhe viktimave të krimeve dhe incidenteve të tjera mund të konfirmohen në standardet e probabilitetit statistikor.

## TË NDIKUAR NGA VIKTIMIZIMI NDAJ KRIMIT

Të anketuarit u pyetën për krimin më të rëndë që kanë përjetuar, “Në përgjithësi, sa keni qenë të prekur?”. Dukshëm, kishte model të njëjtë reagimi në secilën valë të hulumtimit (Tabela 6). Viktimat e krimit nga urrejtja kishin më shumë gjasa sesa viktimat e krimeve të tjera të deklarorin se ishin prekur “shumë” nga përvoja e tyre e viktimizimit - megjithëse për vitin 2018 ndryshimi nuk mund të dëshmohej me standardet e probabilitetit statistikor.

*Tabela 6: Të prekurit nga viktimizimi për shkak të krimit*

	Krimi nga urrejtja		Klime të tjera	
	2018	2023	2018	2023
Në përgjithësi, sa jeni prekur?				
Shumë	27.7*	28.6	22.1	13.8
Mjaftueshëm	38.7*	46.4	30.0	37.4
Vetëm pak	33.6	25	47.9	48.9
I paponduar n	90	60	207	160

Përqindjet e kolonës

\* Dallimi i dukshëm midis krimeve dhe incidenteve nga urrejtja dhe krimeve dhe incidenteve pa një motivim nga njëanshmëria nuk është statistikisht i rëndësishëm.

## NDIKIMI SOCIO-EMOCIONAL

Në të dy valët e hulumtimit, viktimat e krimit nga urrejtja si grup kishin mbi dy herë më shumë gjasa se viktimat e krimeve të tjera të raportonin se kanë pasur probleme të rëndësishme me anëtarët e familjes ose miqtë për shkak të përvojës së tyre të krimit (Tabela 7).

*Tabela 7: Problemet socio-emocionale pas viktimizimit nga krimi*

	Krimi nga urrejtja		Krime të tjera	
	2018	2023	2018	2023
Të qenit viktimë e këtij krimi a ju ka bërë që të keni probleme të konsiderueshme me anëtarët e familjes ose miqtë, duke përfshirë edhe përfshirjen në më shumë debate apo zënka se sa keni bërë më parë, duke mos ndjerë se mund t'u besoni atyre aq shumë?				
Po	30.6	21.4	13.3	9.2
Jo	67.7	78.6	84.3	90.2
Nuk e di	1.7	0	2.4	0.4
Të qenit viktimë e këtij krimi a ju ka bërë që të keni probleme të konsiderueshme me punën ose detyrat e shkollës, apo probleme me shefin, kolegët apo bashkëmoshatarët tuaj?				
Po	15.5	27.3	7.5	11.6
Jo	84.5	72.7	91.9	88.4
Nuk e di	0.0	0.0	0.5	0.0
I paponderuar n	90	60	207	160


Ata gjithashtu kishin mbi dy herë më shumë gjasa të raportonin probleme të rëndësishme në shkollë ose punë pas përvojës së tyre me krimin.

## NDIKIMI PSIKOLOGJIK

Të dy valët e hulumtimit të krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut përfshinin masa të ndikimit psikologjik pas viktimizimit. Konstatimet e valës së vitit 2018 treguan se viktimat e krimeve dhe incidenteve nga urrejtja si grup kishin më shumë gjasa të raportonin nivele më të larta të ndikimit psikologjik sesa viktimat e krimeve të tjera. Megjithatë, shumë nga dallimet e dukshme nuk mund të konfirmoheshin kur gjykoheshin nga standardet e probabilitetit statistikor për shkak të madhësisë së mostrës. Sidoqoftë, kur kombinohen valët e vitit 2018 dhe 2023 (Figura 14), mund të konfirmohen shumica e dallimeve të dukshme midis viktimave nga krimet dhe incidentet e mundshme nga urrejtja si grup dhe viktimat e krimeve dhe incidenteve të tjera të mundshme me standardet e probabilitetit statistikor, përveç përjetimit të zemërimit dhe vështirësive për të fjetur.



Figura 14: Ndikimi psikologjik i viktimizimit të krimit nga urrejtja



## SHQETËSIMI PËR SHKAK TË VIKTIMIZIMIT TË MUNDSHËM NGA KRIMI

Ajo që është shqyrtuar shumë më pak në hulumtimet ndërkombëtare dhe literaturën e politikave është lidhja midis viktimizimit real për shkak të krimit nga urrejtja dhe shqetësimit për viktimizim të mundshëm. Një lidhshmëri i tillë u shqyrtua në valën e hulumtimit të vitit 2018 për krimin nga urrejtja, i cili ofroi njohuri unike për marrëdhëniet midis viktimizimit nga krimi dhe shqetësimit për krimin. Ai zbuloi një model të qartë të dallimit midis të anketuarve që ishin viktima të krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja dhe viktimave nga krime dhe incidente të tjera të mundshme. Veçanërisht, për shumicën e masave në lidhje me shqetësimin për viktimizimin e mundshëm nga krimi, viktimat e krimit nga urrejtja në hulumtim kishin më shumë gjasa sesa viktimat e krimeve të tjera për të deklaruar se ishin mjaft ose shumë të shqetësuar.<sup>31</sup>

Duke pasur parasysh se çështja e lidhjes midis viktimizimit real për shkak të krimit nga urrejtja dhe shqetësimit për viktimizimin e mundshëm mbetet relativisht e pashqyrtuar, kjo pjesë e raportit i çon më tej njohuritë duke krahasuar konstatimet e valëve të hulumtimit për vitin 2018 dhe 2023. Ai gjithashtu shqyrton shqetësimin për krimin e personave që deklaruan se nuk ishin viktima të krimit në të dy hulumtimet për të siguruar një tregues të mundshëm të ndjenjave të pasigurisë dhe ndryshimit me kalimin e kohës (Tabela 8).

Nga konstatimet e paraqitura në Tabelën 8, dallohen një numër modelesh:

- ◆ Për secilin nga treguesit në lidhje me shqetësimin për viktimizimin e mundshëm nga krimi, të anketuarit që deklaruan në hulumtim se kishin përjetuar një krim ose incident në 12 muajt e mëparshëm ishin më të shqetësuar sesa ata që nuk kishin përjetuar ndonjë krim.
- ◆ Të anketuarit që kishin përjetuar krime ose incidente nga urrejtja në 12 muajt e mëparshëm ishin më të shqetësuar se ata që kishin përjetuar krime dhe incidente që i kanë perceptuar si të pa motivuara nga njëanshmëria - me disa përjashtime.


<sup>31</sup> Dallimi i vërejtur në shqetësimin për sulmin fizik për shkak të prejardhjes etnike, racore, kombëtare ose fetare, nuk do të ishte statistikisht i rëndësishëm nëse të dhënat do të gjeneroheshin nga një mostër probabiliteti.

Tabela 8: Shqetësimi për viktimizimin e mundshëm për shkak të krimit

	Anketa e vitit 2018			Komunitet e përfshira në vitin 2018 në hulumtimin e vitit 2023			Komunitet e tjera të përfshira në hulumtimin e vitit 2023		
	Krimi nga urrejtja	Krime të tjera	Nuk është viktimë e krimit	Krimi nga urrejtja	Krime të tjera	Nuk është viktimë e krimit	Krimi nga urrejtja	Krime të tjera	Nuk është viktimë e krimit
Sa i/e sigurt apo i/e pasigurt ndjeheni të ecni vetëm pasi të errësohet në zonën ku jetoni?									
Pak i/e pasigurt ose shumë i/e pasigurt	43.5	35.3	25.1	39.4	31.3	18.1	47.7	26.8	17.2
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse ju futet dikush në shtëpi dhe ju vjedh diçka?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	61.6	69.3	52.7	77.5	49.3	41.8	55.4	49.7	28.0
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse dikush ju grabit dhe plaçkit?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	65.9	67.3	45.0	61.1	49.3	36.1	53.8	42.4	21.3
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse ju vidhet prona?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	66.4	68.8	46.1	69.4	52.2	37.5	60.0	48.1	26.4
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar se do t'ju sulmojnë fizikisht persona të panjohur?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	61.3	57.4	42.6	49.3	44.8	32.4	56.9	34.4	20.0
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse jeni objekt i një sulmi fizik për shkak të përkatësisë suaj etnike, racore ose kombëtare ose fesë suaj?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	56.8	50.6	32.7	48.6	28.8	29.6	47.7	24.0	11.7
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse ju ngacmojnë, bezdisin ose shqetësojnë në vende publike ose në shkollë, fakultet ose punë, për shkak të përkatësisë suaj etnike, racore ose kombëtare ose fesë suaj?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	51.5	41.3	28.8	39.4	21.2	28.1	38.5	21.9	12.9
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse dikush ju sulmon seksualisht?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	39.3	33.5	27.2	19.4	31.3	23.8	29.2	20.8	9.4
Sa jeni ose nuk jeni të shqetësuar nëse dikush ju ofendon ose kërcënon në mediat sociale?									
Mjaft ose shumë i shqetësuar	36.7	21.6	21.9	23.6	19.4	22.3	30.8	23.4	10.4
Nuk përdor asnjëherë media sociale	18.3	27.9	28.6	19.4	10.4	20.9	27.7	24.5	22.0
I paponderuar n	260	295	955	64	77	341	63	184	885

- ◆ Ka një tendencë në rënie të shqetësimit për krimin ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 (Figura 15). Ky është rasti për secilin tregues të shqetësimit të të anketuarve që nuk kishin qenë viktimë të krimit dhe ata që kishin qenë viktimë të krimeve ose incidenteve në 12 muajt e mëparshëm që nuk janë perceptuar si të motivuara nga njëanshmëria. Ekziston gjithashtu një prirje në rënie ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 për viktimat e krimeve dhe incidenteve nga urrejtja në shumicën e treguesve, përveç shqetësimit se do të sulmohen në shtëpinë e tyre dhe do të vidhet diçka, ndërsa prona e tyre do të vidhet në një mënyrë tjetër.

Figura 15: Shqetësimi për krimin



## 8. KONKLUZION

Konstatimet e hulmtimit të paraqitura në këtë raport, tregojnë se ekziston një përputhje e ngushtë midis valëve 2018 dhe 2023 të hulmtimit të krimit nga urrejtja në Maqedoninë e Veriut. Vala e vitit 2023 tregon një shpërndarje shumë më të lartë të viktimizimit nga krimi nga urrejtja sesa sugjerohet nga të dhënat zyrtare dhe OJQ-të. Situata ishte e njëjtë edhe në vitin 2018. Megjithatë, bazuar në krahasimet ndërmjet valëve të hulmtimit të vitit 2018 dhe 2023, shkallët e viktimizimit të mundshëm për shkak të krimit dhe incidenteve nga urrejtja kanë mbetur kryesisht statike.

Pavarësisht nga natyra statike e konstatimeve nga hulmtimi për krimet dhe incidentet e mundshme nga urrejtja midis viteve 2018 dhe 2023, ka disa indikacione të lëvizjes në drejtim të një rënieje të vogël të shkallëve të përgjithshme të viktimizimit nga krimet në përgjithësi që duket se i përshtaten tendencës së vogël në rënie të krimit në vitet e fundit siç tregohet nga statistikat zyrtare. Por dallimet nuk janë ende mjaft thelbësore për të sinjalizuar një ndryshim ndërmjet viteve 2018 dhe 2023 për të gjitha krimet specifike të pyetura në hulmtim kur gjykohen nga standardet konvencionale të probabilitetit statistikor.

Shkalla e raportimit të krimeve dhe incidenteve të mundshme në polici gjithashtu ka mbetur statike ndërmjet viteve 2018 dhe 2023. Krimet dhe incidentet me një motivim të perceptuar të njëanshmërisë kanë më pak të ngjarë të mos raportohen në polici krahasuar me krimet dhe incidentet e mundshme që perceptohen se nuk janë të motivuara nga njëanshmëria.

Është e dukshme, megjithatë, se përqindja e krimeve dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja me një paragjykim të perceptuar politik është ulur. Është gjithashtu e dukshme se ka një tendencë në rënie për shqetësimin lidhur me viktimizimin e mundshëm nga krimi që nga viti 2018.

Së fundi, nga këndvështrimi metodologjik, përfrimi i ngushtë i rezultateve nga valët e hulmtimit të vitit 2018 dhe 2023 tregon se dizajni i hulmtimit ofron një qasje të besueshme dhe ekonomike për hulmtim të shpërndarjes së krimit dhe incidenteve të mundshme nga urrejtja.

